

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7428 E premte 2 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion i Ditës

**Një marrëveshje e re mes Greqisë dhe Shqipërisë, siç ka ndodhur me thuajse të gjitha marrëveshjet mes dy fqinjëve, u shndërrua në molën e sherrit ...**  
Vijon në faqen 20

## Nga DESADA METAJ

**A është mirë me qenë shqiptar?**  


## Opinion i Ditës

**Botërori i 2018" do të marrë një rëndësi gjeopolitike të veçantë, vendi dhe data kur do të zhvillohet kjo garë do ta bëjnë atë një piketë për politikën ...**  
Vijon në faqen 21

## Nga SALI METANI

**4 sfidat gjeopolitike të "Botërorit 2018"**



Rrëfëhet të "Studio e hapur" kreu i PD-së

## Lulzim Basha: Rama s'merr vesh nga shteti. Qëndron në pushtet, sepse ne jemi indiferentë

Kreu i PD-së nxjerr dokumentin: Seitaj do tregonte sa para mori Tahiri

Nga ENI VASILI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, deklaroi mbremë në "Studio e Hapur" në "News 24" se nuk ishte skenar i opozitës, sjellja sot në Kuvend, por një sjellje e përsëritur e mazhorancës, që do t'i heqë fjalën opozitës. ...

Në faqen 4

## INTERVISTA/ "12 MILJET' ATHINES IA JEP KONVENTA. RAMA TE JETE I MATUR" PAKTI DETAR, XHUFI: KOTZIAS "U HODHI NJE KOCKE" GREKEVE

Historiani i njohur: Të djathtët kanë qenë gjithnjë "esadistë. Eshtrat greke? T'i marrin në atdheun e tyre. LSI-ja e futi e para çështjen çame në program



(Në foto) Pellumb Xhufi. Harta që tregon ndarjen e kufijve detarë mes Shqipërisë dhe Greqisë

Në faqen 6



**INTERVISTA**  
**Kryeministri: Çështja çame, çështje e të drejtave të njeriut**  
Në faqen 5

**INSTRUKSIONET**  
**Ambasada e SHBA: Si të aplikoi për bashkimin familjar**  
Në faqen 12

## NGA FERDINAND SAMARXHI



## Një jetë në rrugën e Zotit, presidenti Ilir Meta dekoron Sulejman Rexhepin

Në faqen 14-15

## MASR: Kush ka të drejtë të hyjë në provime

## Ja rregullorja e re e maturës

Afatet e plotësimit të formularit A1 dhe A1Z

Nga VOLTIZA DURO  
Të gjithë nxënësit që ndjekin studimet në vitin e fundit të shkollës së mesme, tashmë mund të njihen me rregulloren për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2018 në Republikën e Shqipërisë. Kjo e fundit ka marrë miratimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë pas firmosjes së Urdhrit nr:672 nga vetë ministrja Lindita Nikolla. Sipas rregullore, provimet e maturës zhvillohen vetëm me shkrim për të gjithë ata ....

Në faqen 13

## Përse KLSH nuk mund të auditojë "ARMO"-n ?

KLSH mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 163, pika c) dhe në ligjin nr.154/2014, datë 27/11/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 10, "Kompetenca", pika "e", në përputhje me funksionin e tij, ka për kompetencë dhe kontrollon :

"auditimin e përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike dhe financiare të Shtetit në personat juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti".

Mbështetur në nenin e mësipërm, KLSH nuk mund të auditojë kompaninë "ARMO"sh.a., në të cilën Shteti ka vetëm 15% të aksioneve, më pak se gjysmën, prej vitit 2008.

Nëse deputetët e Kuvendit të Shqipërisë dëshirojnë që të auditohet "ARMO"sh.a., duhet të miratojnë ose ndryshimet në Kushtetutë dhe Ligj, ose të hartojnë një Ligj të veçantë për këtë rast, çka do të ishte me rëndësi dhe vlerë të lartë për financat publike, duke parë rastet e shumta të hidhura të shpërdorimit të rolit të së drejtës shtetërore në ndërmarrjet e përbashkëta ku Shteti ka pakicë aksionesh, të cilat kanë sjellë humbje të konsiderueshme në Buxhetin e Shtetit dhe në interesat e qytetarëve.

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**

## SEANCA KUVENDORE BLLOKIMI

### GRUPI I PD-së/VENDIMET

Partia Demokratike mbledhi dje grupin e saj parlamentar pas seancës së tensionuar në Kuvend. Grupi doli me disa vendime. "Do vazhdojmë përballjen. Do nxjerrim dhe faktojmë të gjitha skandalat. Do mbajmë kontakte me qytetarët. Do të ketë reagim", janë porositë e kryetarit Basha për deputetët e PD-së.



### BLLOKIMI

#### PAGA

Opozita nuk u largua dje nga foltorja duke e mbajtur të bllokuar. Pas paralajmërimeve, Ruçi vendosi përjashtimin e Spahos nga seanca dhe heqjen e pagës për ditën e punës. Opozita vijoi bllokimin e Kuvendit, ndërsa Ruçi kërkoi nga shërbimet e institucionet, Garda, që të nxjerrë jashtë kryetarin e grupit të PD-së.



### KRYEMINISTRI

#### FILMIMI

Kryeministri Edi Rama postoi një video në "Facebook" nga ajo që po ndodhte në Kuvend, ku Basha dhe skuadra e tij bëjnë zhurmë dhe mbajnë peng foltoren. Me pak fjalë dhe duke goditur opozitën, që sipas tij është pa lidhshmëri dhe vizion, Rama shkruan: "Vizion, program, skuadër, lidhshmëri për Shqipërinë".

Kryemadhi: Protestat do të vazhdojnë. Këpucët i kisha me taka të rënda

# Protesta të pandalshme, Basha: Mafia në pushtet, Kuvendi një zezanë "Opozita nuk do të pranojë kurrë t'i mbyllet goja"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, e quajti super skandal ekstradimin e Nezar Seitajt në Itali. Basha bëri të qartë se opozitës nuk do t'i mbyllet goja nga kjo kupolë krimi e droge, teksa e cilësoi ekstradimin e financierit të grupit "Habibaj", Nezar Seitaj, në Itali, si skandalin më të madh në këto 27 vjet histori. Në oborin e Kuvendit, z.Basha deklaroi: "Mafia në pushtet e ekstradoi për t'i mbyllur gojën dhe për të mbrojtur Ramën e Tahirin. Mafia në pushtet ekstradoi duke shkelur të gjitha ligjet me qëllim që t'i mbyllë gojën për të mbrojtur Tahirin dhe më pas Ramën për të mbrojtur kupolën në pushtet. Sot opozita kërkoi fjalën në lidhje me rregulloren për të kërkuar praninë e Edi Ramës, i cili u fsheh siç u fsheh para bashkimit të shqiptarëve më 27 janar. Kërkoj praninë e Ramës për t'u përballur me këtë skandal, më të madhin në 27 vite. I rëndë është bashkëpunimi i ministrit të Brendshëm me bandat e drogës dhe përfitimit me milionat e drogës", theksoi z.Basha. Por sipas tij, "vendi është në kthetrat e mafies. Opozita nuk do të pranojë kurrë t'i mbyllet goja. Ky nuk është më një parlament, kjo është një zezanë, pengesa kryesore për drejtësi, barazi para ligjit; pengesa kryesore për avancimin e shqiptarëve në rrugëtimin e tyre evropian". Kurse kryetarja e LSI paralajmëroi

se do të vazhdojnë protestat. Kryemadhi tha se Rama nuk shpëton dot nga përfshirja e tij në trafikun e drogës. "Protestat nuk do të ndalojnë në asnjë moment. Nuk janë thjesht thirrja e qytetarëve në bulevard, janë nga më të ndryshmet. Keni protestat te minatorët, naftëtarët, te banorët e Fierit që janë kundër incineratorit. Keni protestat te gjimnazistët, te studentët që janë për tarifa më të ulëta. Keni

protesta te deputetët e kudo. Edhe tek ata qytetarë, të cilët quhen shtrës e mesme, por që Edi Rama i shkriu dhe i shkatërroi me taksat e larta. Mos u çudisni, çdo ditë e më shumë urrejtja dhe mallkimet ndaj tij po shtohen për shkak të asaj pasigurie që ka krijuar në Shqipëri. Sot i kisha kë-

pucët me takë të rëndë, mos u shqetësoni, çizmjia është simboli, unë mendoj që çizmjia më e rëndë që është çizmjia e krimit të organizuar, e cila u ka rënë në kokë shqiptarëve, tashmë do të kthehet në çizme të çdo shqiptari që i bie në kokë Edi Ramës", tha Kryemadhi.



## PD paralajmëron bojkot të Kuvendit

### Spaho: Do na kenë përballë, çdo mjet kundër bandave

Kryetari i grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho paralajmëroi se opozita do të përdorë të gjitha format, madje edhe bojkot të Kuvendit, derisa ata të arrijnë objektivin e tyre. Në një deklaratë për mediat jashtë Kuvendit, kur Spaho u pyet nëse do të ketë bojkot, ai tha: "Të gjitha format do t'i përdorim derisa të arrijmë objektivin". Spaho bëri të qartë se aksioni opozitar do të vazhdojë me frymën e protestës së 27 janarit. "Ne do ta vazhdojmë këtë betejë, është beteja e opozitës. Ne do të jemi këtu sa kohë që këta të vazhdojnë në këtë rrugë dhe do të na kenë përballë dhe do të përplasen alternativat me qëndrimin tonë. Do të përdorim të gjitha format dhe mjetet për t'iu kundërvënë kësaj bande. Aksioni i sotëm vazhdoi me frymën e pro-



testës, kështu do të vazhdojë edhe në ditë e tjera, madje duke intensifikuar formën e aksionit tonë", u shpreh nënkryetari i PD-së. Ndërsa, nënkryetari i Kuvendit, Edi Paloka paralajmëroi përshkallëzim të veprimeve kundër Ramës. Nga ambientet e jashtme të Kuvendit, ku qëndruan deputetët e PD-së edhe pas

mbylljes së seancës, nënkryetari i Kuvendit, Edi Paloka deklaroi: "Ata që menduan se na hoqën fjalën në parlament, ta dinë mirë se nuk na e hoqën fjalën në shesh. Rama asnjë ditë nuk do të shtrihet të flejë i qetë apo të zgjojohet i qetë. Në çdo seancë, kudo që të jetë, do të ketë veprime të tilla".

## Deputeti i PD-së kap "peshkun e madh"

Në mënyrë simbolike, deputeti i PD, Ervin Salianji tha se e ka kapur ai "peshkun e madh". Në një deklaratë për mediat jashtë Kuvendit, ai deklaroi se "peshkun" donte t'ia jepte kryeministrit, por u pengua nga punonjësit e Gardës. "Sot është data 1 shkurt, ka kaluar janari dhe i vetmi peshk i madh që është kapur është ky që e kam kapur unë. Për të gjithë qytetarët shqiptarë, unë i kam justifikuar paratë e taksave të tyre. Tentova ta fus në parlament për t'ia dhënë kryeministrit në mënyrë simbolike, por punonjësit e Gardës më thanë që këtu lejohen vetëm 'peshkaqenët'. Peshqit e mëdhenj nga Tahiri te Nazer Seiti, kurse peshkaqenët janë të gjithë këtu", deklaroi z.Salianji.

### RRËZIMI

Për herë të dytë Kuvendi rrëzoi dje kandidaturat për anëtarë të KLPJ dhe KLGJ, pasi opozita nuk mori pjesë në votim. Ky projektligji kërkonte shumicë të cilësuar me 93 vota.



### PETRIT VASILI

"Ky parlament është i rrëmbyer nga një grup kriminal që drejtohet nga i pari dhe i vetmi kryeministër tradhtar dhe kuizling, pasi vendin e ka pushtuar krimi", theksoi z.Vasili.







**NDËRPRERJA**

**SQARIMI**

PD sqaroi përplasjen në Kuvend: "Ruçi është në shkelje të rregullores me ndërprerjen e fjalës së Spahos. Marrë shkas nga shkelja e rëndë e ligjit për ekstradimin e Seiti me urdhër të kryeministrit, z. Spaho do të kërkonte praninë në sallë të Ramës. Ndërprerja brutale e fjalës solli reagimin e grupit të opozitës".



**DHURATA ÇUPI**

**DEBATI**

Deputetët e opozitës rrethuan foltoren, ndërkohë që kryeparlamentari Ruçi i dha fjalën deputetit Fadil Nasufi nga vendi. Ky i fundit akuzoi opozitën, por kjo e tensionoi edhe më shumë situatën. Deputetja e PD, Dhurata Çupi, i shkoi pranë dhe i kërkoi të flasë në foltore: "Dil fol në foltore, jo këtu. Dil atje".



**JORIDA TABAKU**

**MIRATIMI**

Deputetja e PD, Jorida Tabaku komentoi miratimin e projektligjit në Kuvend për aeroportin e Vlorës. Sipas saj, do t'i hapë rrugë procedurës korruptive dhe ky draft nuk bazohet as në ligjet e cituara dhe as në Kushtetutë. Tabaku flet për hije dyshimi në veprimet e qeverisë dhe ministrave.



Deputetët e opozitës kontrollohen para se të hyjnë në Kuvend, Paloka: S'jemi terroristë

# Ruçi përjashton Spahon, opozita bllokoi seancën: Hajdutë, kriminelë

## Fjalor banal i deputetëve, deri te gishti i mesit

Valentina Madani

Opozita protestoi dje brenda dhe jashtë parlamentit duke bllokuar seancën plenare dhe miratimin e ligjeve. Për afro 4 orë u vunë re debate dhe akuzat të ashpër mes palëve, përplasia e bidonëve të ujit mbi tavolinë, deri tek fjalori banal i deputetëve. Fillimisht deputetët e opozitës u përballën me kontrollin e sigurisë së parlamentit. Kjo u bë publike nga nënkryetari demokrat, Edi Paloka, i cili tha se janë kontrolluar sikur të ishin terroristë. "Zoti kryetar, sot kur deputetët e opozitës hynë në sallën e parlamentit, u kontrolluan sikur po kalonim në zonën... Ne jemi deputetë, nuk jemi as terroristë, as hajdutë, as kriminelë. Nëse ka nga ata i ke aty lart... Nëse ka frikë ai lideri juaj global, nuk mund ta trajtoni deputetin si rreckë. Ai ta ketë të qartë se sado kontroll të bëjë, aty këpucë kemi të gjithë", deklaroi z. Paloka. Kryeparlamentari Ruçi tha se do të bënte verifikimin, pasi nuk ishte në dijeni. Që në minutat e para, opozita kërkoi debat për ekstradimin drejt Italisë të Seita, dëshmitarit kyç të drejtësisë shqiptare për çështjen "Tahiri-Habilaj". Seanca nisi me tensione që në momentin kur kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, përjashtoi kryetarin e grupit parlamentar Edmond Spaho, i cili mori fjalën dhe nisi të fliste lidhur me ekstradimin e Nezar Seitaj. Edhe pse seanca u ndërpre për 20 minuta, sërish deputetët e opozitës nuk u larguan nga foltorja dhe vijuan të thërrisnin: "Hajdutë! Kriminelë!" Seanca e nisur



**ANULIMI**

Kryeministri Rama nuk dha asnjë deklaratë pasi doli nga Kuvendi. Ai paralajmëroi se do dilte para mediave, por deputetët e PD, të vendosur jashtë parlamentit vazhduan thirrjet: "Hajdutë! Kriminelë"! Prandaj Rama anuloi prononcimin për median dhe u largua me makinën e tij.



**Berisha: Aeroporti i Habilajve**

**Mazhoranca voton pro negociatave për aeroportin e Vlorës**

Me 74 vota pro të mazhorancës, Kuvendi miratoi fillimin e negociatave për ndërtimin e aeroportit të Vlorës. Votimi u krye ndërsa foltorja e Kuvendit ishte e bllokuar nga deputetët e opozitës, të cilët thërrisnin: "Hajdutë! Kriminelë!" Ndërkohë në një prononcim për median jashtë Kuvendit, ish-kryeministri Berisha e quajti aeroportin i Habilajve, aeroportin e Vlorës. "Kështu po e quaj për shkak se po bëhet me një cmim absolutisht 5-6 herë më të madh se aeroporti i Kukësit. Çdo vlonjat dhe vlonjate, çdo shqiptar dhe shqiptare duhet ta dijë se çfarë është mbi 20 milionë shkon në xhepat e Edi Ramës dhe individëve të tjerë që nuk kanë asnjë lidhje me Vlorën e Shqipërinë, por vetëm me luksin e pasuritë e tyre të krimin", tha z. Berisha. Sa i takon ekstradimit të Nezar Seitaj, ai deklaroi: "E bën këtë akt të paprecedent, sepse janë të ngërthyer në një skandal të paprecedent. Edi Rama, në shkelje të Kushtetutës dhe çdo ligji ka përzënë dhe ekstradimit personin kyç të bandës së Habilajve me urdhër të Saimir Tahirit vetëm dy ditë pasi ai kishte shprehur vullnetin për t'u bërë dëshmitar i penduar dhe i mbrojtur i drejtësisë".

**Deputetët e LSI: Të pamoralshëm, nis kodi luftës**

**S'e lënë të flasë, Balla: Keni zgjedhur të bëni kukuvajkat**

Deputetët e opozitës penguan dje fjalimet e kolegëve të mazhorancës brenda, ashtu edhe jashtë sallës së Kuvendit. Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla është penguar të flasë nga dy deputetë të LSI. Kejdi Mejmetaj dhe Floida Kërpaçi. Balla po fliste për aeroportin e Vlorës, ku dy deputetët e reja të LSI-së i ndërhyjnë, duke mos e lënë të flasë. "Keni zgjedhur të bëni kukuvajkat, më vjen shumë keq. Populli gjykon e vlerëson", u tha Balla deputetëve, duke shtuar: "Kanë ngelur edhe disa kalamaj tjerë. Sot është një ditë shumë e rëndësishme, urime populit të Vlorës! Do të jetë një ndër aeroportet më

të mira në Ballkan". Ndërkohë, menjëherë pasi u largua Balla, deputetja Nora Malaj hodhi akuzat që forta ndaj deputetëve të mazhorancës, duke thënë se ka mbaruar kodi i etikës dhe ka filluar kodi i luftës dhe ngacmimit seksist në parlament", tha zj. Malaj. Kurse deputetja tjetër e LSI-së, Mehmetaj u shpreh: "Shikoni kush nga ne mund të ketë frikë, asnjë përveç asaj edukate që përfaqësoi sot Taulant Balla dhe Rama". Ndërsa deputetja Kërpaçi tha: "Bëjnë moral të pamoralshmit".



prej orës 10:30 u mbyll më 12:30 me thirrjet e deputetëve të opozitës. Ndërkohë, gjatë seancës deputetët socialistë mbajtën fjalën nga vendi. Ruçi lexoi edhe emrat e deputetëve të PD-së që kishin shënuar emrin për të mbajtur fjalën në seancë, por asnjë prej tyre nuk e mori fjalën. Në një moment kur Ruçi përmendi emrin e Bashës për t'i

dhënë fjalën dhe e ironizoi: "Është akoma në miting". Ruçi kërcënoi Bashën duke i thënë: "Ulu poshtë, mos bëj si halabak. Mos bëj si halabak dhe mos i prek punonjësit e shërbimit aty". Kryetari demokrat, Lulzim Basha, iu bashkua korit të deputetëve të tij. Basha me deputetët në kor thërrasin: "Hajdut, kriminel!" Ndërsa, kryeminis-

tri Edi Rama u kërkonte të tijve t'i mbaronin shtepi fjalimet dhe fillonte kundërshtarit e tij. Por opozitarët goditën me shishe tavolinat, ndërkohë që thërrisnin "Kriminelë"... Në këtë situatë, kryeministri iku, gjë që u pa si dobësi nga opozita, deputetët e së cilës qëndruan aty për të penguar këtë herë deputetin Taulant Balla.

## SITUATA POLITIKE REAGIMET

Kreu i PD-së nxjerr dokumentin: Seitaj do tregonte sa para mori Tahiri

# Basha: Rama është një ordiner, që s'merr vesh nga shteti

"Qëndron në pushtet për shkak të indiferencës sonë"

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, deklaroi mbremë në "Studio e Hapur" në "News 24" se nuk ishte skenar i opozitës, sjellja sot në Kuvend, por një sjellje e përsëritur e mazhorancës, që do t'i heqë fjalën opozitës. Sipas tij, opozita nuk mund të pranojë marrjen peng të një njeriu që do kthehej në dëshmitar të drejtësisë, duke treguar sa para kishte marrë ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri nga trafikantët "Habilaj". Kreu demokrat theksoi se sistemi kriminal është ndërtuar me vetëdije nga Edi Rama, jo se më përpara nuk ka ekzistuar lidhja e krimit me politikën, por Rama i përfshiu drejtpërdrejtë personat e dënuar si deputetë dhe kryetarë bashkë. Sipas tij, "Edi Rama nuk është Satanai, është një ordiner që nuk merr vesh nga shteti, por është në pushtet për shkak të indiferencës sonë".

**Z.Basha, ishte një skenë e parapërgatitur ajo që pamë në Kuvend?**

E kundërta, ishte një sjellje e përsëritur nga mazhoranca për të na hequr të vetmen të drejtë në atë parlament, fjalën. Kryetari i grupit e mori fjalën në një moment të paprecedentë, kur shteti shqiptar, 5 apo 6 institucione kanë rrëmbyer dëshmitarin kyç të dosjes "Tahiri-Habilaj". Pra, ai kërkoi praninë e kryeministrit dhe ministres së Drejtësisë, e cila u përçoll me lezet. Edi Rama ka zhurmuar këtë megaskandal. Rrëmbimi i Nazer Seitit është më i rëndësishëm se publikimi i përgjimeve për Tahirin nga antimafia italiane. Është ekstraduar kur avokati i tij po niste procedurat për ta shpallur si i penduari i drejtësisë, pra ai do pranonte të rrëfente në detaje bashkëpunimin dhe bashkëpunëtorët. Llogaritari i bandës, njeriu që disponon sa para shkuan tek Tahiri, sa tek policia në momentin që avokati u vu në lëvizje u rrëmbye. Ligji shqiptar ndalon ekstradimin e një perso-



ni në hetim. Ky person nuk mund të ekstradohet edhe për një arsye të thjeshtë. Sa kohë është në hetim. Këtu tek ju ministri i Brendshëm tha se u arrestua më 20 tetor me urdhër të Interpolit. Ky është një mashtrim. Ja ku e keni dokumentin e policisë

### ÇËSHTJA "SEITAJ"

"Skandali është edhe më i thellë. Ky proces ka nisur 2 herë dhe filtrat e shtetit kanë funksionuar dhe kanë thënë që ky person nuk mund të ekstradohet, sepse Prokuroria e Krimeve të Rënda po e heton", tha z.Basha.

së Vlorës, procesverballi kur ky ndalohej me urdhër të Prokurorisë së Krimeve të Rënda për veprën penale për të cilën po hetohet Tahiri dhe Habilajt. Ky është dokumenti që e vërteton. Xhafaj dy ditë më parë gënjeu,

sepse ai e ka këtë dokument. Skandali është edhe më i thellë. Ky proces ka nisur 2 herë dhe filtrat e shtetit kanë funksionuar dhe kanë thënë që ky person nuk mund të ekstradohet, sepse Prokuroria e Krimeve të Rënda po e heton. Është një mashtrim bajat i rëndomtë, sepse ministria e Drejtësisë ka nënshkruar 3 letër-porosi për Prokurorinë e Katanias. Janë gjurmët e gishtave të një kupole mafioze për të ndihmuar Saimir Tahirin dhe çështja e tij të zvarritet, apo mundësisht të mbyllet.

**Përpjekja juaj në parlament dështoi?**

Ne nuk kishim synim të dilnim jashtë rregullores. Kryetari i grupit parlamentar kërkoi që në përputhje me rregulloren, kërkoi të flitej për një çështje të rëndësishme. Ruçi bëri atë që bën gjithmonë, i mbyll gojën opozitës. Kishim motivin për të shpallur nisim të tonë dhe për të denoncuar aferën korruptive për aeroportin e Vlorës. Me

të gjitha mjetet duan të shpëtojnë Tahirin, se është i lidhur me Ramën.

**Çfarë paralajmëroni se do të bëni?**

Ai nuk është një parlament, por një dhomë që i mungon legjitimiteti. Ata duan ta përdorin atë dhomë për të garantuar paprekshmërinë e shokëve të tyre. Se me këta kriminelë kanë ardhur në pushtet. Tjetërsuan vullnetin e popullit. Ne do bëjmë atë që bën opozita, do të vazhdojmë të denoncojmë. Bëmë një protestë madhështore. Dhe të mundësojmë që të mbrohen sa të jetë e mundur liritë e qytetarëve. Duke kritikuar, duke ftuar qytetarët në protestë me qëllim që keqeverisja të ndikojë sa më pak.

Njeriu që kishit të parin në listë në Vlorë, është oligark dhe votoi për aeroportin që ju thoni është korruption. Ju thoni që erdhi Rama e i mori këta e ndërtoi këtë të keqe. Ky sistem i ndërtuar nëpërmjet përdorimit të oligarkëve, ky sistem mashtrimi, ka qenë edhe në kohën e PD. Puna është si të heqim këtë sistem?

**Në kohën tonë s'ka pasur oligarkë, s'ka pasur në Partinë Demokratike.**

Ata kanë hyrë për bizneset e tyre në parlament, jo për popullin. Ideja që kam unë sot, është çfarë po bën ti që të mund të ndalojë këtë mashtrim parash droge në këtë terror urban? Por me sa shoh unë, nuk ka as opozitën e asaj partisë tjetër që keni ju, LSI-së, por as juve s'po ju shoh...

Turp të të vijë, mashtron, gënjën! Të të vijë turp! Pse more se është i pasur ai?! Është Agron Shehaj, i ka bërë ato lekë në punë të ndershme dhe ka shkuar aty për të dhënë dhe jo për të marrë. Votova pro aeroportin kundër aferës korruptive. Mendova që vota ishte në parim dhe jo një votë në komision për të. Incineratorët i kam denoncuar unë i pari në Kuvend, faktin që janë në pronësi të një personi. Ju akoma thoni sa keq po na qeveris opozita, por këtu problemi është se Edi Rama



bashkëqeveris me krimin, nuk ka asnjë të përbashkët me ne. Në aferën e incineratorëve, shqiptarëve u merren qindra miliona euro. E kam denoncuar unë projektin e ndërtimeve korruptive, se shërbejnë për pastrimin e parave të drogës. Ne patëm vizion ekonomik real, rritëm pagat. Mos bëni sikur ranë nga qielli, apo sikur i ka bërë Edi Rama këto.

**Cila është zgjidhja e situatës?**

Edi Rama nuk mund të largohet me 1 protestë, aksioni opozitar do të vazhdojë. Ne do të paraqesim alternativën tonë. Do të vijojmë aksionin tonë opozitar dhe qëllimi ynë është që

### STRATEGJIA

"Edi Rama nuk mund të largohet me 1 protestë, aksioni opozitar do të vazhdojë. Ne do të paraqesim alternativën tonë, do të vijojmë aksionin opozitar dhe qëllimi ynë është që keqverisja të ketë një kosto sa më të vogël për qytetarët shqiptarë", theksoi z.Basha.

keqverisja të ketë një kosto sa më të vogël për qytetarët shqiptarë. Duhet reagim qytetar patjetër dhe ne kemi marrë një përgjegjësi. Duhet të ketë sindikata që reagojnë, por nuk reagojnë. Duhet të reagojë shoqëria civile, por nuk reagon. Duhet të reagojnë mediat, që në çdo studio i fyen, por nuk reagojnë. Pse nuk reagojnë naftëtarët, të papunët, studentët, por presin që opozita të thërrasë protestë? Në Shqipëri kanë marrë fund

proceset politike përsa kohë ka rënë sistemi i zgjedhjeve dhe shkelet Kushtetuta. Përballë kësaj të keqeje duhet të bashkohemi të gjithë. Edi Rama nuk është Satanai, është një ordiner që nuk merr vesh nga shteti, por është në pushtet për shkak të indiferencës sonë. Reagimi i intelektualëve dhe elitave është inekzistent në këtë vend. Sistemi kriminal është ndërtuar me vetëdije nga Edi Rama, jo se më përpara nuk ka ekzistuar lidhja e krimit me politikën, por Rama i përfshiu drejtpërdrejtë personat e dënuar si deputetë dhe kryetarë bashkie. Droga kulmoi në 2016-ën, sepse Edi Rama ngriti në sistem të dënuarit për trafik droge apo për krime të tjera të rënda. Nuk mund të themi sot që jemi të gjithë njësoj, pasi kriminelët i bëri vetëm Edi Rama deputetë dhe kryetarë të bashkive. Problemi kryesor sot është infrastruktura kriminale që u ndërntua. Sot po bëhet diversiteti i krimit, ku nga kanabis po kalohet te heroina dhe kokaina, pastaj do të kalohet te pastrimi i parave përmes ndërtimit dhe turizmit.

**A keni një ekip tuajin?**

Njerëz që duan të kontribuojnë mund ta bëjnë edhe me një vështrim kritik. Ky është prioriteti im. Partia Demokratike është e hapur, unë vetë dhe jemi në kërkim të mekanizmave për të krijuar aleancën e vlerave kundër aleancës së krimit. PPE tha se e vetmja forcë politike që kishte një program tërësisht të zbatuar ishte ai i paraqitur nga Partia Demokratike. Nuk mund të përhapet kultura "Ruçi" edhe në studiot televizive. Alternativa jonë është fundi i monopoleve, oligarkëve, taksave të ulëta, fundi i krimit në qeverisje, transparenca.





Kryeministri zbulon rolin e ekspertëve amerikanë e italianë për varrezat greke

# Akuzat për faljen e defit, Edi Rama: Marrëzi! Pakti i ri me Greqinë, historik

## "Autorizimi nga presidenti, kur ekspertët ta finalizojnë teknikisht"

Marrëveshja e re për detin me Greqinë do të jetë për Shqipërinë shumë më e mirë se ajo antikushtetuese e vitit 2009 dhe do të jetë e bazuar katërcipërisht në kornizën e përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë". Kështu deklaroi dje kryeministri Edi Rama, i cili foli në emisionin "Real Story", të gazetarit Sokol Balla.

Kryeministri Rama siguroi se "skuadra shqiptare në këtë negociatë ka nga mbrapa një ekspertizë të nivelit më të lartë ndërkombëtar për këto tema, ashtu si edhe për varrezat". "Skuadra shqiptare është e superpërgatitur. Këtu është një ekip inxhinierësh shqiptarë dhe një ekip inxhinierësh dallkukësh shqiptar. Marrëveshja e 2009-ës është tradhtit, atë tradhtit do ta mbajnë ata që e bënë në histori", shtoi Rama.

**Përse gjendemi sërish në situatën pa kapele?**

Së pari, unë mund t'i siguroj të gjithë se ç'ka po ndodh është himni më solemni i marrëzisë pseudopatriotike. Është një marrëzi e bazuar tek fakti që jo vetëm ka injorancë të madhe, por edhe ka një nevojë të madhe për tu kapur pas një fjalë, e cila është një fjalë, ajo e ministrit grek dhe për të ngritur një furtunë në kushtet kur lepurit i frikës fle te reforma në drejtësi, te vetingu, fle tek e nesërmeja e atyre që e stimulojnë këngën e kësaj marrëzie.

Ministri i Jashtëm grek thjesht dhe vetëm ka konfirmuar çka është dhe shkruar në nenin 3 të Konventës Ndërkombëtare, që parimi i 12 miljeve është parim i Konventës Ndërkombëtare të detit. 12 miljet janë sot. 12 miljet Shqipëria i ka regjistruar në OKB në 1990. Por, le ta ndërtojmë narrativën pak më ndryshe. Kush e hapi këtë problem? Greqia kërkoi rinegocimin e marrëveshjes së detit apo ne? Greqia ishte e lumtur me marrëveshjen e 2009-ës, e cila sipas Gjykatës Kushtetuese, ishte antikushtetuese. Greqia për 3 vite me radhë i iku kërkesës për të rihapur një marrëveshje të re. Kush e hapi çështjen çame? E hapi Greqia apo ne?! E futëm në programin tonë në 2013-ën dhe sot e diskutojmë në tryezë, me një nuancë. Greqia thotë nuk njoh çështje çame edhe ka një arsye, se për Greqinë çështja çame do të thotë pretendim territorial në tokën e Greqisë. Kemi në pretendime territoriale në tokën e Greqisë? Jo, në asnjë mënyrë. Çështja çame ka një emër të tillë, por përfaqëson problemet e një komuniteti shqiptar që lidhen me të drejtën përkuajtimore, pronën dhe të drejtën e lëvizjes. Ne nuk na intereson nëse Greqia thotë nuk njoh çështje çame, sepse për ne është e qartë, ne nuk duam terriore, por ne duam të drejta të njeriut.



### PIKAT E PAKTIT

"Do kemi marrëveshje të re nga e cila do dalim me kokën lart dhe jo me këmbët në ujë, për atë që ne i themi çështja çame dhe atë që ata e pranojnë si problematikë të të drejtave e njeriut. Po ju them që në prill këto njëje do këputen dhe do firmoset dokumenti i partneritetit strategjik mes Shqipërisë e Greqisë", tha Rama.

Është i saktë ministri, ku e thotë që nuk njohim çështje çame, që sipas tyre është pretendim territorial. Por në tryezë diskutojmë dhe e ka thënë që shqiptarët kërkojnë me agresivitet. Së treti, ligjin e luftës kush e vuri në tryezë? E vunë grekët?! Dhe ky zotëria, Berisha dhe nënshkruesi famëkeq i një marrëveshjeje famëkeqe, që është njollë në fjalimin që ka mbajtur kur u firmos marrëveshja, ka thënë: "Me mikun tim Karamanlis jemi dakord që mes dy vendeve tona s'ka çështje të hapura. Jo kishte 3 të hapura, ligji i luftës, çështja çame dhe kjo e detit tani. Këto tri çështje me çfarë logjike, me çfarë arsytimi. Njerëzit e zakonshëm e viktima të kësaj propagande hidhen në kazan duke menduar që ne në tavolinë paskemi lëshuar më shumë se sa ç'u lëshua në 2009. 12 miljet janë parim ndërkombëtar, janë edhe në marrëveshjen aktuale. Kanë qenë edhe më parë të regjistruara nga Shqipëria në OKB dhe ministri grek është korrekt.

**Pse e nisën ata të parët shpjegimin dhe jo ju?**

Ne nuk kemi arsye të shpjegojmë asgjë për sa kohë jemi në një tryezë negociimi dhe presim të shkruhet e zezë mbi të bardhë dhe me të gjitha gjasat në fillim të prillit. Jemi në një proces, ku po finalizojmë një përpjekje 3-vjeçare e gjysmë. Po u them të gjithë shqiptarëve marrëveshja e re, jo e korrigjuar do të jetë shumë më e mirë se sa marrëveshja dhe do të jetë në kornizën e përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese.

**Meqë lind nevoja për një marrëveshje të re, me sa metra do ta**

**përmirësoni marrëveshjen e re? Nëse del që është e njëjta marrëveshje?**

Kush i prishi marrëdhëniet? Marrëdhëniet i acaruum ne. Pse i acaruum ne, jo me qëllim për t'i acaruar, por vumë midis nesh dhe fqinjët tri çështjet që për të tjerë përpara nuk ekzistonin. Do jetë një nga faqet më spektakolare të historisë shqiptare. Prisi prillin të finalizohet. Negociatat nuk janë "Big Brother".

Negociatat kanë strategjinë e tyre, taktikat e tyre dhe në negociatë nuk është një darrë që hanë e pinë, është shah. Ne jemi në diskutim. Ne kemi një vijë të kuqe që e kemi vendosur qysh në fillim. Kur i thoshim se ne kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, pala tjetër thoshte ç'na duhet ne se mos është gjykata jonë. Sot do të jetë e garantuar në parimin e baraslargësisë, por e axhustuar. Është teknikalitet.

### Ata 334 km do i merrni?

334 km kanë qenë opinion. Vendimi i GJK nuk flet për 334 km dhe po ju them që skuadra shqiptare në këtë negociatë është një skuadër që ka nga mbrapa një ekspertizë të nivelit më të lartë ndërkombëtar, siç kemi edhe për çështjen e varrezave. Skuadra shqiptare është super e përgatitur. Në 2009 u gjet një ekip inxhinierësh shqiptarë dhe një lidhesh dallkukësh. Ajo marrëveshje është tradhtit. Mund ta tradhtosh vendin tënd edhe nga injoranca.

**Një nga motivet është e njëjti që kemi ju sot, vota "pro e Greqisë në BE?"**

Në 2009-ën qeveria shqiptare falli territor për të marrë mbështetje politike. Ne e vumë në rrezik mbështetjen e Greqisë për çeljen e negociatave, sepse problemet i hapëm ne. Nuk është se Greqia na vuri në përpara marrëveshjen e detit dhe tha hajde na jepni ca.

**A mos vallë edhe ju, jeni pak në mospërrëzime me vendimin e GJK? Presidenti aktual e ka thënë që nuk është informuar për këto negociata...**

Nëse jemi në fazën që jemi futur në momentin e negociatave teknike. Ky është një teknikalitet që nuk jam në gjendje ta them. Kjo sigurisht që meriton një hulumtim. Nuk dua të zgjatem, sepse nuk dua të bëj dëm në një proces, duke ndezur zjarre në anën tjetër. O shqiptarë ne i kemi hapur këto probleme, jo fqinjtë. Ne nuk i hapëm që të krijojmë më shumë probleme, por që të zgjidhim në reciprocitet të plotë.

**Pse e larguat në Itali dëshmitarin kyq të çështjes "Tahir"?**

Nuk kam dëgjuar të thotë kush se është gabim. U ekstradua në duart e prokurorisë italiane një person

i kërkuar zyrtarisht nga drejtësia italiane. U çua në duart e asaj, që këta të daulles e quajnë antimafia. Nëse nuk do kishte ndodhur, këta do thoshin se nuk ua çuan se duan ta mbajnë që t'i mbyllin gojën.

**Ilir Meta duhet të ishte informuar...**

Të mos flasim për këtë a duhej njoftuar Ilir Meta, kjo është anësore. Mos e merrni për të mirëqenë nëse kjo nuk ka ndodhur. Dua t'ju bëj një saktësim, është një detaj për të cilin u interesova. Ekspertët ulen për të fiksuar teknikalitetin një proces që u finalizua politikisht.

**Për çështjen çame do të preket si çështje pronësie. Meqë këtu do ketë varrezat greke, a do ketë një monument për gjenocidin çam në Greqi?**

Greqia ka një paranojë që Shqipëria ka pretendime territoriale ndaj saj dhe kjo mban emrin "çështja çame". Ne nuk kemi pretendime, madje ndihemi të cuditur që nivele të larta greke thonë që qeveria e Edi Ramës kërkon Shqipërinë e madhe, kërkon Çamërinë. Dhe kësaj paranoje ne do t'i japim fund. Nga ana jonë, çamët janë identifikuar si çamë, gegët, si gegë, por qofshin gegë, toskë, janë shqiptarë. Këtu ne flasim për shtetas shqiptarë, që kanë një të kaluar dhe kanë mbrapa në histori në shtetin grek, prona në Greqi. Ata pengohen të lëvizin lirshëm. Pse duam ne të hiqet ligji i luftës? Nuk është problemi se do vijë Greqia e do na luftojë ne, por ligji i luftës është bishti mbrapa dardhës, por efektet e ligjit të luftës na pengojnë për disa gjëra që lidhen konkretisht me pronën.

**Ndërkohë grekët kanë filluar punën me varrezat në Shqipëri?**

Ne duam një marrëveshje të veçantë, sepse do ketë disa marrëveshje, se deti është më vete, për emigrantët. 4 milionë euro dalin nga xhepat e atyre njerëzve që luftojnë atje, për dokumente. Pse? Sepse Greqia nuk ka pranuar vullën apostile. Nuk po hyjmë të patentat. Dogana a janë një problem. Ne po shkojmë drejt një marrëveshjeje, ku do të kemi pikë doganore me grup të përbashkët. Është një negociatë shumë delikate.

Ne u thamë grekëve mund ta ekzekutojmë këtë marrëveshje, por do ulemi në tavolinë për të historinë e 70 viteve. Ne jemi të drejtë dhe luajalë. Në momentin kur pamë hapje, ne i hapëm rrugën, por me një proces të mirëstuduar. Kemi ekspertë amerikanë të pas-Bosnjës. Kemi grup të përbashkët. Janë përfaqësuesit tanë atje, me ata grekë, edhe italianët janë përfaqësuar atje. Kjo histori është shumë e kopsitur.

**Do të ketë të tjera?**

Jo, nuk do ketë absolutisht të tjera, në Bularat e Këlcyër. Aq sa janë do kenë vëndprehenj e tyre.

### ÇAMËT

"Në marrëveshje tani ne kemi këmbëngulur të fusim të drejtën përkuajtimore dhe të gjitha këto janë lëvizje që duhet të na çojnë te qëllimi, por duke realizuar vendosjen në pozicione të drejta. Ne nuk duam të bëjmë në këto negociata diçka që e cenon tjetrin', u shpreh kryeministri.

### NEGOCIATAT

"Mbështetjen e Greqisë për hapjen e negociatave e vuri në rrezik kokëfortësia jonë. Mbështetja e tyre jo vetëm që do të jetë, por do të jetë aktive, sepse do të firmosim një dokument të partneritetit strategjik", u shpreh dje Rama.

# PAKTI ME GREQINË

## INTERVISTA

Darina Tanushi

**H**istoriani i njohur, Pëllumb Xhufi sqaroi dhe, se deklarata e ministrit të Jashtëm grek Kotzias është një "kockë" që ai ka dashur t'ia hedhë opinionit grek që është "fanatikisht nacionalist, helenocentrik". Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", ndërsa justifikon qeverinë shqiptare se në këtë fazë ajo duhet të ruajë konfidencialitetin, Xhufi shpreh: "Përcaktimi i kufirit detar në vijën e 12 miljeve është një cak i vendosur nga Konventa e OKB mbi detin, e ashtuqajtura Konventa e Montego Bay-t e vitit 1982, së cilës u detyrua t'i përmbahet edhe qeveria e Enver Hoxhës duke hequr dorë nga vendimi i saj i mëparshëm për ta vendosur në mënyrë të njëanshme vijën kufitare detare në gjerësinë e 16 miljeve".

**Zoti Xhufi, pas negociatave me dy raunde që u zhvilluan mes ministrave të Jashtëm të Shqipërisë dhe Greqisë, duket se ka deklarata të ndryshme prej tyre. Të martën ministri i Jashtëm grek tha se kishin rënë dakord me palën shqiptare për të shtrirë në 12 milje ujërat territoriale, gjë që nuk pohohet konkretisht nga ministri Bushati? Ç'mendim keni krijuar nisur nga këto informacione që kemi?**

Shikoni, negociatat shqiptaro-greke mbi disa çështje të pazgjidhura, ose të zgjidhura keq, deri tani janë zhvilluar në një frymë konfidencialiteti. Për rrjedhim, komunikimi me mediat e me publikun ka munguar ose ka qenë i pamjaftueshëm. Gjykoj se në këtë fazë të bisedimeve, maturia dhe indiskrecioni janë të detyruar. Sigurisht, z. Kotzias "e theu" kodin e heshtjes, duke avancuar ndonjë element të bisedimeve. Dihet që qeveria e z. Cipras ka të bëjë me një opinion publik, që në një pjesë të mirë të tij është fanatikisht nacionalist, helenocentrik, ksenofob e anti-evropian. Faji i një sistemi shkollor e edukativ, që duke filluar nga viti 1821, ka gatuar gjenerata të tëra grekërisht nacionalistë. Kuptohet, që këtij lloj opinioni z. Kotzias ka dashur t'i japë paradhënje ndonjë "kockë", që të pushojë së lehuri, duke i shtuar atij si "fitore" të negociatorëve grekë dy sende që, në fakt, qeverisë shqiptare ia imponon e drejta ndërkombëtare. Përcaktimi i kufirit detar në vijën e 12 miljeve është një cak i vendosur nga Konventa e OKB mbi detin, e ashtuqajtura Konventa e Montego Bay-t e vitit 1982, së cilës u detyrua t'i përmbahet edhe qeveria e Enver Hoxhës duke hequr dorë nga

Historiani i njohur: "12 miljet" Athinës ia jep Konventa. Qeveria të jetë e matur

# Pakti detar, Xhufi: Kotzias "u hodhi një kockë" grekëve

Të djathtët kanë qenë "esadistë". Eshtrat greke? T'i marrin në atdhe.



Historiani Pëllumb Xhufi

vendimi i saj i mëparshëm për ta vendosur në mënyrë të njëanshme vijën kufitare detare në gjerësinë e 16 miljeve. Sigurisht, ky rregull vlen aty ku dy vende ndahen nga një hapësirë e konsiderueshme detare. Por nuk vlen në rastet kur mes dy vendesh ekziston një hapësirë detare e vogël, siç është rasti i detit që ndan Korfuzin grek nga bregdeti shqiptar përballë tij. Më duket se, më në fund, ka folur drejt për këtë çështje edhe ish-komandanti i flotës sonë, kryenegociatori shqiptar i bisedimeve të dështuara të vitit 2008, z. Gerveni.

**Pakti detar me Greqinë është një betejë të cilën Partia Socialiste e fitoi kur ishte në opozitë e tashmë po e rinegociat ndërsa është vetë në qeveri. Ç'mendim keni për këtë proces që ka nisur? A ju duket i rregull? A duhet të kishte pasur konsultime me ekspertë më përpara?**

Pikërisht, për arsyen që ju thatë, qeveria socialiste është e detyruar të jetë e matur në rinegociatim e paktit detar me Greqinë. Ajo ka në anën e saj një vendim të betonuar të Gjykatës Kushtetuese, që bazohet sa në ligjin shqiptar, që edhe në ligjin ndërkombëtar. Veç të tjerash duhet të përballë edhe me një faqe të ndritur të historisë saj, që e bën atë të ndryshme nga fryma esadistë që ka karakterizuar marrëdhëniet e qeverive të djathta shqiptare me fqinjët grekë në këta 100 vjet të shtetit sh-

qiptar. Unë guxoj ta theksoj me të gjithë forcën, se hedhja poshtë e paktit detar me Greqinë nga Gjykata Kushtetuese më 2009 i detyrohet ekskluzivisht Partisë Socialiste, që e denoncoi atë në Gjykatën Kushtetuese, dhe atyre 5 anëtarëve të asaj gjykatë, që me profesionalizëm të lartë e me kurajë intelektuale e qytetare iu kundërvunë diktatit të qeverisë Berisha dhe ndryshe nga 4 kolegët e tyre, e mbi bazën e dispozitave të Kushtetutës sonë e të vetë Konventës së OKB, hodhën poshtë vendosmërisht qysh në votimin e parë atë marrëveshje antishqiptare. Sigurisht, këtu është vendi të kujtoj të gjithë ata ekspertë e profesorë të shquar e patriotë, si Myslim Pashaj, Ksenofon Krisafis, Besnik Bakiu, Sabit Brokaj, Vladimir Beja, Arben Puto, Ago Nezha, si dhe shoqatat atdhetare "Labëria", "Mallakstra" etj., e në mënyrë të veçantë gazetarin e ri Tedi Blushi, që ishin të parët që ngritën zërin dhe denoncuan atë marrëveshje. Kujtoj gjithashtu, se marrëveshja e detit u bë larg veshëve e syve të opinionit publik shqiptar dhe pa informuar për të partinerët tanë të rëndësishëm, duke iu bindur edhe në këtë pikë një kërkese eksplicite të qeverisë konservatore greke të z. Karamanlis. Do ta lija të paplotësuar kuadrin e partive, shoqatave dhe individëve që u shquan në betejën për hedhjen poshtë të asaj marrëveshjeje, po të mos kujtoja,

se atë kohë pozicioni i Partisë Socialiste kundër udhës Basha-Bakojanis u mbrojt me energji e dinjitet përpara Gjykatës Kushtetuese e në media të ndryshme, nga z. Saimir Tahiri.

**Një tjetër diskutim që është hapur pas këtyre negociatave është edhe "çështja çame". Greqia deklaroi se nuk e njeh "çështjen çame" dhe as e diskuton, ndërsa tjetër gjë pohohet nga ministri e qeveria shqiptare. Përse kjo diskordancë qëndrimesh ose më saktë kjo "druajtje" e palës shqiptare për ta diskutuar me forcë këtë çështje?**

Para se të flasim për "drojën", le të themi që Partia Socialiste, sot në pushtet, është partia që në vitin 2013 e përfshiu çështjen çame në programin e saj si dhe në programin e qeverisë Rama që doli nga zgjedhjet e atij viti. Deri atëherë, vetëm LSI e kishte "çështjen çame" në programin e saj. Dhe duhet thënë, se qeveria socialiste arriti ta përfshijë "çështjen çame" në bisedimet zyrtare me palën greke, madje arriti të tërheqë deklarata tepër të rëndësishme të përfaqësuesve të lartë të BE mbi nevojën e zgjerimit të dialogut greko-shqiptar duke përfshirë edhe këtë çështje me ndjeshmëri të lartë për shqiptarët. Padyshim duhet bërë më shumë, sidomos në drejtim të përvijimit të një "road map"-i të artikuluar në kohë e në rëndësi për zgjidhjen doradurës të problemit. Por, gjykoj, se përveç qasjes ndonjëherë të sipërfaqshme e deklarative të qeverisë, për mungesën e një politike e të një aksioni energjik në promovimin e çështjes çame ka përgjegjësi edhe PDIU, partia që do të duhej të përfaqësonte interesat e popullsisë çame, e cila, gjykoj unë, nuk ka ofruar mbështetje dhe nuk ka ushtruar presionin e duhur mbi qeverinë. Gjithësesi, unë jam i prirur të besoj se çështja çame vazhdon të mbetet në shqetësimet e projektet e qeverisë socialiste. Vetë integrimi i Shqipërisë në BE, që është një prioritet i saj, do të ishte një kontribut i drejtpë-

drejtë edhe për çështjen çame, nga momenti që brenda një kuadri evropian, një çështje e tillë do të gjente shtratin ideal ku do mund të realizoheshin shkallë-shkallë aspiratat legjitime të popullsisë çame. Mirëpo, në këtë vështrim, drejtuesit politikë të komunitetit çam duhet të jenë të parët që të reflektojnë qëndrime e sjellje në përputhje me vlerat evropiane. Mirëpo, ngjarje të këtyre kohëve të fundit, po vërtetëjnë fatkeqësisht të kundërtën.

**Heqja e ligjit të luftës, sipas ministrit Bushati nuk lidhje me çamët. Sipas jush a përfitojnë ata nga heqja e ligjit?**

Ministri Bushati ka të drejtë. Ligji i Luftës i shpallur me një dekret të mbretit të Greqisë në vitin 1940, u lidh me një efekt të drejtpërdrejtë, që ishte vënia nën sekuestro administrative të pronave të shtetasve shqiptarë në Greqi, të cilët përçaktoheshin nga ligji në fjalë si "shtetas armiq" përderisa ishin banorë të një "shteti armik". Atë kohë çamët vazhdonin të ishin shtetas të Greqisë dhe efektet e ligjit të luftës nuk mund të shtriheshin mbi ta. Kështu, nga abrogimi i ligjit të luftës do të duhej të përfitonin imediatisht ata pronarë shqiptarë, disa qindra, të cilët qysh në kohën e Perandorisë osmane kishin blerë toka, pyje, kullota, dyqane në Maqedoni, Thesali, Livadhja e provinca të tjera të Greqisë. Këtu përfshihen edhe pronat e mëdha që zotërojnë në ato provinca institucione fetare, siç është rasti i teqesë bektashiane të Turbali Sulltanit në Thesali.

**Përse është zgjatur kaq vite nga Greqia heqja e këtij ligji?**

Së pari, sepse falë ligjit në fjalë, shteti grek ka shfrytëzuar e shfrytëzoh pasuri të pallogaritshme të pronarëve shqiptarë, që mbahen të bllokua falë këtij ligji. Nga ana tjetër, ky ligj shfrytëzohej e shfrytëzohej nga qeveritë greke të pasluftës si një "paliativ" për të qetësuar vrerin nacionalist të partive e të qarqeve konservatore greke, të




çilat e kanë pasur anti-shqiptarizmin një flamur të përherëshëm të betejave të tyre politike. Por, nuk është kjo kryesorja. Ekzistenca e ligjit të luftës u mundësonte qeverive nacionaliste greke të mos njihnin kufirin e vendosur nga Fuqitë e Mëdha në Londër, më 1913, dhe që u konfirmua si i tillë edhe në konferencat e Parisit, më 1926 e 1946. Ende nuk ka një marrëveshje për kufirin mes qeverive të Tiranës e Athinës, edhe pse një marrëveshje e tillë është zakonisht e para që dy vende fqinje nënshkruajnë më syre. Dhe në fund, duhet thënë se në kushtet kur krijohen situata të jashtëzakonshme, e të tilla mund të krijojnë, ligji i luftës mund t'i shërbejë një qeverie ekstremiste për të përligjur një invazion të mundshëm të territorit shqiptar në emër, gjoja, të mbrojtjes së minoritetit grek nga sulmet e plaçkitjet e "turko-shqiptarëve". Këtu nuk janë fantashkenç. Mjafton të kujtojmë vitin 1949 apo 1997, kur trupat greke invaduan apo tentuan të invadonin territorin e të ashtuqajturit "Vorio-Epiri" nën pretekste të ngjashme. Ne nuk duhet të harrojmë se bashkimi i Shqipërisë së Jugut me Greqinë është një konstante politike e qarqeve nacionaliste, që janë gjithnjë prezente në qeverisjen e Greqisë.

**Qeveria e Shqipërisë u duk se iu përgjigj e para rritjes së një epoke të re në marrëdhëniet me Greqinë, në momentin kur mori vendim për gjetjen e eshtrave të ushtarëve grekë dhe ndërtimin e dy varrezave, veprim për të cilin gjithashtu ka kritika. Ju si e komentoni këtë përgjigje të qeverisë shqiptare?**

Unë mendoj si shumëkush tjetër, se kërkimi e gjetja e eshtrave të ushtarëve të huaj që janë vrrarë në territorin shqiptar, është një gjest njerëzor. Ajo që nuk miratohet është fakti që eshtrat e këtyre ushtarëve u dëshkan varrosur të gjitha në tokën shqiptare, në komplekse madhështore morale, që nesër mund të kthehen në vende pele-





← grinazhi nacionalist apo, akoma më keq, në targete të veprimeve e të provokimeve nacionaliste, që mund të ndërlikonin marrëdhëniet shtetërore Shqipëri-Greqi. Në këtë kuptim e kuptoj shqetësimin e atyre që e shohin insistimin e qeverisë greke për të ngritur 1, 2, 3 e më shumë vorreza greke në territorin shqiptar, si një pretendim të natyrës rivendikative. Por, ndërsa në bisedojmë për këtë çështje, politikanët tanë, qoftë në qeveri e qoftë në opozitë, lejuan që dy varrezat, e Kosinës dhe e Bularatit, të ngriheshin edhe pa patur një marrëveshje të shkruar mes dy qeverive, marrëveshje që u nënshkrua vetëm më 2008 nga qeveria Berisha. Mbi bazën e saj, pala shqiptare është e detyruar të lejojë kërkimet për trupat e ushtarëve grekë të rënë në vitet 1940-1941 në territorin shqiptar dhe vendosjen e tyre në dy vorrezat e sipërpërmendura. Uroj që numuri i tyre të mos shtohet. Personalisht do konsideroja zgjidhje më të arsyeshme ngritjen e një monumenti përkujtimor në nderim të ushtarëve grekë, ndërkohë që eshatrat e tyre të ktheheshin në atdhe.

**Kuptohet që në një raport dypalësh do të duhet të vendoset një lloj marrëveshje "me jap, të jap". Por a duket se pala jonë s'është po të lëshon më shumë se duhet kundrejt Greqisë?**

Përkundrazi, në rastin e marrëdhënieve e të negociatave aktuale me Greqinë më duket se nuk vlen ky rregull. Në marrëdhëniet historike me shtetin grek, shqiptarët kanë qenë gjithmonë pala që ka pësuar. Do mjaftohesha të kujtoja vetëm një faqe të dhimbshme e mjerisht të harruar të këtyre mar-

**PETRO KOÇI**  
"E drejta prej 12 mijlesh e shtrirjes territoriale në hapësirën detare është si për Greqinë, ashtu edhe për Shqipërinë", u shpreh dje, zv.ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, në një reagim lidhur me negociatat mes Shqipërisë e Greqisë.

rëdhënieve, atë të verës së vitit 1914, kur trupat greke të pushtimit kryen tentativën e parë për spastrimin e Shqipërisë së Jugut nga popullsia vendase shqiptare, duke kryer masakra të përbindshme, që përfaqësuesit e Fuqive Ia kujtuan kryeministrit grek Venizelos edhe në Konferencën e Paqes së Parisit, më 1919. Më tej, për abrogimin e Ligjit të Luftës, Shqipëria nuk ka pse të lëshojë diçka në këmbim. Greqia duhet ta heqë atë pa kushte, madje duke kërkuar falje për një turp që do ta shoqërojë historinë moderne të saj edhe për shumë kohë. Objekt "këmbimi" nuk mund të bëhet as marrëveshja e re për ndarjen e kufirit detar. Nën presionin e "votës për NATO-n", qeveria greke arriti ta bindë qeverinë shqiptare të pranojë një ndarje të kufirit detar, që nuk gjën mbështetje as në Kushtetutën e Shqipërisë, dhe as në ligjin e në konventat ndërkombëtare. Vetë zonja Bakojanis e qeveria greke e vitit 2009 ishin të ndërgjegjshëm për këtë, përderisa marrëveshjen e arritur pa mund e pa bujë me qeverinë Berisha, nuk guxuan ta kalojnë për miratim në parlament.

Faleminderit

Ish-kryeministri "kërcënon" kreun e qeverisë për paktin me Greqinë

# Berisha: Marrëveshja e detit kalon vetëm po shkelën mbi trupat tanë

## "Marrëveshja jonë ishte për një distancë të balancuar"

Ish-kryeministri Sali Berisha e paralajmëroi dje kryeministrin Edi Rama se nuk mund të firmosë marrëveshje për shitjen e detit me Greqinë, pasi më parë duhet të kalojë nga trupat e deputetëve të opozitës. Në një reagim për mediat jashtë sallës së Kuvendit, Berisha u shpreh dje: "Përjashtoi kreun e grupit parlamentar në mënyrë që të kalojë hajdutërisht dhe të zhduket nga parlamenti, pasi ka bërë aktin më të rëndë në historinë 105-vjeçare të këtij vendi. Ka bërë pazarin e kufirit detar me Greqinë, në të cilin ministri i Jashtëm grek thotë se 'fituan zgjerimin e ujërave me 12 mijle'. Të gjithë ata që mendojnë se kjo deklaratë është propagandistike, gënjejnë veten e tyre. Ministri grek e ka deklaratën 100% të vërtetë. Marrëveshja jonë ishte ajo që të takon në linjë e mesit, në distancë të baraslarguar. Marrëveshja e tij është 'po të jap të urremja, llokmën po e mbaj për vete'. S'mund ta kalojë atë marrëveshje, pa kaluar mbi trupat tanë. Asnjë cm s'do kalojë", tha Berisha. Sipas tij, me këtë marrëveshje, kryeministri Edi Rama ka shitur gazin dhe naftën që gjendet nën ujë. "Me vendosjen e copave në tavolinë, Edi Rama ka dorëzuar fushat e gazit më të mëdha të Mesdheut dhe Jonit, që gaz është 100% i sigurt, por edhe naftën. Sipas marrëveshjes sonë, i takonin 100% Shqipërisë. Marrëveshja jonë ishte ajo që të takon në distancën e baraslarguar, marrëveshja e tij është po të jap të urremja dhe po mbaj llokmën për vete. Kjo është marrëveshja e Edi Ramës. Pasi karrigia u lëkund, është i gatshëm të bëjë çdo lloj kompromisi. Ky nuk mund ta kalojë atë pa kaluar mbi trupat tonë. Rama të matet mirë se do ta paguajë me të gjitha çmimet e merituar nëse guxon të konkludojë një marrëveshje të tillë", theksoi në deklaratën e tij, Berisha. Sipas tij, "ka situatë të tensionuar midis popullit shqiptar, qever-

isë së Habilajve, qeverisë së trafikantëve, qeverisë së tregtarëve të detit, qeverisë së piramidës së Amos. Këto janë revoltat. Kjo që shihni këtu është vetëm një shprehje e atij tsunami të revoltës popullore që ekziston jashtë kësaj qeverie".

**MYSLIM PASHAJ**  
Koloneli i marrëveshjes së parë detare me Greqinë, Myslim Pashaj, sqaroi të gjithë zërat që kritikojnë negociimin e dytë të paktit se ende nuk ka asnjë marrëveshje. "Marrëveshje nuk ka. Veçse bisedime për t'u përafëruar tek një rinegociim. Janë bërë biseda 'in general' për standarde që dihen, me urtësi për t'u afruar për një marrëveshje të re", u shpreh Pashaj, duke thënë se institucionet shqiptare nuk funksionojnë, se ato duhet ta sqarojnë.



Ish-kryeministri Sali Berisha

### Ksenofon Krisafi: Deklarata e Kotzias nuk duhet marrë si argument

Profesori Ksenofon Krisafi deklaroi dje në media se nuk duhet të përdoret si argument deklarimi i ministrit grek, Nikos Kotzias, që pala shqiptare pranoi propozimin për shtrirjen e ujërave tona territoriale deri në 12 mijle detare. Sipas tij, "nëse ajo që atribuohet si deklarim i ministrit Kotzias pranohet si e vërtetë, kuptimi i saj duhet interpretuar logjikisht që kjo gjerësi, normalisht prerogativë e palës greke, do të shtrihet deri në 12 mijle detare vetëm në ato segmente të



Ksenofon Krisafi

bregdetit grek, përballë të cilave shtrihen hapësira detare, ku gjerësia ndërmjet dy brigjeve është minimalisht më e madhe se 24 mijle detare. Nëse është më e vogël, në bazë të nenit 15 të Konventës së Montego Bay, ajo do të përcaktohet me marrëveshje midis tyre. Në varësi të rrethit natyror dhe të konfigurimit gjeografik, në raport me fuqijtë përballë ose në krah, do të zbatohen parimi i barazlshësisë (ekuivallancës) ose/dhe i ndershmërisë-drejtësisë (ekitesë)", shpjegoi Krisafi.

### Deputeti i PS: U ndihmuan nga ultranacionalistët serbë

Erjon Braçe: Nuk ka "shitje 2" për detin, Berisha e Basha tradhtarë

Deputeti socialist, Erjon Braçe deklaroi dje se nuk ka "shitje 2" për detin. Në një reagim të tij në rrjetin social "Facebook", Braçe u shpreh dje: "Shitja e detit në gjirin e Sarandës është ajo e para, unike. Ka autorë dy udhëheqës të poshtër, an-

ive të fashistëve e nazistëve në këtë vend, pa harruar asnjëherë edhe ndihmën e gjithëgjendur e të paguar shtrëntje të ultranacionalistëve serbë. Nuk do nodhë kurrë, t'ua marrë kusht tërë këto meritë", u shpreh Braçe. Sipas tij, "gjithkujt që ka dëgjuar atë këngën me ato '12 mijlet detare', i revoltuar kot-gjithnjë nga padija, dua t'i sugjeroj të lexojë një njeri të ditur, të paanshëm e që interesin kombëtar nuk e ngatërron me politikën e ditës, Ksenofon Krisafit", sugjeron Braçe.



Erjon Braçe

**PERMBARUESI GJYEQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ**  
"Përmbarusi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e trette për shitjen e pasurisë se paluajtshme % pise ideale takuese e dëblit Hysen Mehmet Kaso, tek pasuria se paluajtshme e llojshme "Trulli", me Nr.Pasurie 7/91, Volumi 11, Faqe 23 në Zonën Kadastrale Nr.8130, me sipërfaqe totale 186.70 m<sup>2</sup>, nga e cila ndërtesa me sip. 62.70 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Rr. "Haxhi Sina", Tiranë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorëve Shasime Mera, Ajet Dema, Lirim Kasrati, për shumat 90'144 (nëntëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e kater)Euro dhe 880'015 (stejtëqind e tetëdhjetë mijë e pesëmbdhjetë)Leke.  
Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është në shumën 67'200 (gjashtëdhjetë e shtate mijë e dyqind)Euro.  
Ankandi zhvillohet në datë 14.02.2018, ora 16.00 në zyrën e përmbarusit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682209471, 0695370060, email : ermirgodaj@zyraperbarimit.com."

**PERMBARUESI GJYEQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ**  
Përmbarusi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e dyte për shitjen e pasurisë se paluajtshme "Trulli", me Nr.Pasurie 7/91, Volumi 14, faqe 97, Zona Kadastrale 8370, me sipërfaqe totale 186.70 m<sup>2</sup>, nga e cila ndërtesa me sip. 62.70 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Rr. "Haxhi Sina", Tiranë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorëve Shasime Mera, Ajet Dema, Lirim Kasrati, për shumat 90'144 (nëntëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e kater)Euro dhe 880'015 (stejtëqind e tetëdhjetë mijë e pesëmbdhjetë)Leke.  
Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është në shumën 67'200 (gjashtëdhjetë e shtate mijë e dyqind)Euro.  
Ankandi zhvillohet në datë 12.02.2018, ora 16.00 në zyrën e përmbarusit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682209471, 0684054605, email ermirgodaj@zyraperbarimit.com."

**STUDIO PERMBARIMORE GJYEQESORE "KREON" me PERMBARUESI GJYEQESOR SUELA METHOKHA**  
Dt 05.02.2018 ora 16:00 '  
Përfundon Ankandi i Tretë për pasurinë:  
-Pasuria "Apartamenti" me sip. 55 m<sup>2</sup>, Nr. pasurie 212/15+1-5, Z. K 2140, Vol. 2, Fq. 33, me adresë Kërcaull (Gosë), Kavajë. Me çmim 1 247 400 Lekë  
Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PERMBARIMORE GJYEQESORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma Iliria), Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

Presidenti i Republikës: Bashkëveprim për parandalimin e rasteve me fund tragjik

# Meta: Jo më amnisti për të dënuarit për dhunë në familje

## "Do të kundërshtoj faljet për këto çështje"

Voltiza Duro

Gjatë mandatit si president, Ilir Meta nuk do të japë më asnjë amnisti për personat e dënuar për ushtrim dhune në familje. Kjo deklaratë është bërë nga vetë Meta gjatë koncertit të bamirësisë "Ende ka jetë" të organizuar nga shoqata "Të ndryshëm dhe të barabartë". Në fjalën e tij përshëndetëse, Presidenti i Republikës së Shqipërisë theksoi se rastet e vdekjeve tragjike të Ariela Muratit e Fildez Hafizit duhet të vënë më tepër në lëvizje instancat përkatëse për të parandaluar rënien viktimë të dhunës apo trafikimit. "Rastet e fundit tragjike të Ariela Muratit dhe Fildez Hafizit na bëjnë më të vetëdijshëm se që nga qeverisja qendrore, pushteti lokal, qendrat komunitare e sociale, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe çdo punonjës policie, prokuror e gjyqtar; të gjithë duhet të bashkëveprojmë për të parandaluar rënien viktimë të dhunës e trafikimit të çdo vajze e gruaje shqiptare, të çdo të mituri apo personi në nevojë", tha Presidenti i Republikës, Ilir Meta. Ai më tej theksoi se gjatë mandatit të tij nuk do të trajtojë më raste të faljeve të dënimit për personat e dënuar për dhunë në familje. "Gjatë mandatit tim si President i Republikës nuk do të trajtoj me falje të



Ilir Meta gjatë koncertit të bamirësisë



### PRESIDENTI ILIR META

"Rastet e fundit tragjike të Ariela Muratit dhe Fildez Hafizit na bëjnë më të vetëdijshëm se që nga qeverisja qendrore, pushteti lokal, qendrat komunitare e sociale, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe çdo punonjës policie, prokurorë e gjyqtarë; të gjithë duhet të bashkëveprojmë për të parandaluar rënien viktimë të dhunës e trafikimit, të çdo vajze e gruaje shqiptare, të çdo të mituri apo personi në nevojë".

dënimit, asnjë person i cili është dënuar për dhunë në familje dhe njëkohësisht do kundërshtoj çdo amnisti të veprave penale të dhunës në familje apo të lidhura me to", - u shpreh më tej Meta në fjalën e tij. Presidenti i Republikës gjithashtu apeloj për një

bashkëveprim të ri e të fuqishëm të gjitha institucioneve në vend për të rritur fuqinë denoncuese ndaj çdo rasti dhune dhe ndëshkuesmërinë maksimale sipas ligjit ndaj këtyre kriminelëve që po tronditin themelet e shoqërisë dhe familjes shqiptare. Kon-

certi i bamirësisë "Ende ka jetë", i organizuar nga shoqata "Të ndryshëm dhe të barabartë" kishte si qëllim kryesor mbledhjen e të ardhurave që do të shkojnë për të ofruar shërbime për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit dhe dhunës.



Foto ilustruese

## "Do të ofrohen nga 'e-Albania'"

### Blendi Klosi: Reduktohen 1400 dokumente në vit

1400 dokumente në vit reduktohen nga raporti i komitetit të shtetit në fushën e turizmit dhe mjedisit. Është kjo shifra e bërë publike nga ministri Klosi gjatë një takimi me grupe të interesit në këto fusha në prani të zvkryeminstres Senida Mesi dhe ministrit të Bujqësisë, Niko Peleshi. Në fjalën e tij, ministri Klosi tha se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është nga të parat ministri që ka dorëzuar paketën me reduktimin e dokumenteve për lehtësimin e raportit midis biznesit e komunitetit dhe shtetit. "Realisht ndihim shumë mirë që jemi nga ministritë e para që kemi dorëzuar paketën, duke reduktuar plot 23 dokumente, apo mbi 35 për qind të të gjithë dokumenteve që ka Ministria e Mjedisit për sa u përket licencave. Po ashtu, shumë dokumente do të gjenerohen nga zyrat përkatëse të ofrimit të shërbimeve përmes platformës elektronike "e-Albania" ose nëpërmjet ndërveprimit dhe komunikimit mes institucioneve. Reduktojmë kështu në masë të madhe numrin e kontakteve të panevojshme", - tha ministri Klosi. Kreu i Turizmit dhe Mjedisit bëri me dije se janë 9 projektvendimet në Këshillin e Ministrave duke ndryshuar 23 akte me qëllim lehtësimin e procedurave dhe shkurtimeve e burokracisë në zyrat e shtetit.



Blendi Klosi

**unicef** for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)  
Albania Country office

**CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST**

The UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF), ALBANIA Country Office, would like to announce a Call for Expression of Interest addressed to Civil Society Organizations (CSOs) for a prospective partnership with UNICEF Albania Country Office in the implementation of the activity "Supporting national efforts in planning and delivering Social Care Services for families and children".

For further details on the required partnership and on how to respond to the Call, please consult UNICEF Albania ([www.unicef.org/albania](http://www.unicef.org/albania)) and UN Albania ([www.un.org/al](http://www.un.org/al)) websites.

Applications from interested CSOs must be delivered to UNICEF Tirana Office not later than **12 February, 2018, at 16:00 hr.**

Applications must be submitted in a sealed envelope, clearly marked "**EO-ALBA-2018-001 - Call for Expression of Interest - Supporting national efforts in planning and delivering Social Care Services for families and children**".

at the following address:

**United Nations Children's Fund (UNICEF)**  
Rruga "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë,  
Tiranë, Albania  
Tel.: + 355 4 454 8400  
Website: [www.unicef.org/albania](http://www.unicef.org/albania)

**EPSA** SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"  
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- 1- Apartament** me nr.5/131+1-20, Zk.8532, vol.12, fq.60, me sip.98 m2 e ndodhur ne Lgj."Konferenca e Pezës", Sh.1, K.3, Ap.20, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandë është** 3,920,000 (tre milion e nëntëqind e njëzetë mijë) Lekë.
- 2- Njesi** me nr.4/122+1-N, Zk.8533, vol.11, fq.188, me sip.40 m2 e ndodhur ne Lgj."15 Tetor", P.25, Sh.11, K.1, Ap.N, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandë është** 4,000,000 (katër milion) Lekë.
- 3- Truall** me nr.52/34, Zk.3981, vol.9, fq.192 me sip.3020 m2 e ndodhur ne Sheq, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandë është** 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë) Lekë.
- 4- Truall + ndërtesë** me nr.52/44, vol.12, fq.132, Zk.3981, me sip.truall 6134 m2 dhe me sip.ndërtese 2160.2 m2 e ndodhur në Fshatin Sheq i Madh, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandë është** 59,440,000 (pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dyzetë mijë) Lekë.
- 5- Godinë** me nr.3/166, vol.11, fq.242, me sip.totale 290.6 m2, Zk.8534 me vendodhje në Rr."Apollon", Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandë është** 51,064,000 (pesëdhjetë e një milion e gjashtëdhjetë e katër) Lekë.
- 6- Truall** me nr.108/35, Zk.1791, vol.10, fq.248, me sip.500 m2 e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandë është** 2,720,000 (dy milion e shtatëqind e njëzetë mijë) Lekë.
- 7- Truall** me nr.108/36, Zk.1791, vol.10, fq.249, me sip.2000 m2 e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandë është** 10,400,000 (dhjetë milion e katërqind mijë) Lekë.

**Ankandi per shitjen e te gjitha pasurive te sipërcituara do te zhvillohet ne date 13.02.2018, ora 16.00 ne seline e shoqerise EPSA SHPK ne adresen Rr "Ismail Qemali", Pall Fratar, K.6, Tirane.**

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne [www.epsa.al](http://www.epsa.al)



Do të shtohen pikat e shërbimit për t'u dhënë mundësi të gjithë klientëve

# Përditësimi i të dhënave, OSHEE: Shtyhet afati deri në mars 2018

## Abonentëve që nuk deklarojnë adresat u ndërpritet energjia

Ornela Manjani

**A**bonentët e Operatit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, që duhet të plotësojnë apo ndryshojnë të dhënat, tashmë kanë më tepër kohë për të bërë përditësimet e nevojshme. Afati i caktuar më 31 janar ka sjellë radhë të gjata në sportele, ku me mijëra klientë po saktësojnë të dhënat. Në këto kushte OSHEE vendosi vijimin e procesit të përditësimit të të dhënave deri në mars 2018. Paralelisht me shtyrjen e afatit, do të shtohen pikat e shërbimit, për t'i dhënë mundësi të gjithë klientëve t'i përgjigjen detyrimit kontraktual për saktësimin e të dhënave. Ky proces është i detyrueshëm për ata abonentë të cilëve u rezultojnë papërditësuar kontrata e furnizimit me energji elektrike në faqen zyrtare të OSHEE, për klientët që nuk i është vendosur një ngjithësi në banesën e tyre, si dhe për klientët që gjatë procesit të intervistave nuk janë gjetur në banesë apo kanë refuzuar të kryejnë përditësimin. Individët që nuk kryejnë këtë proces rrezikojnë ndërprerjen e energjisë elektrike, për të cilën OSHEE shprehet se nuk është qëllimi në vetvetë, por rëndësia e përditësimit të të dhënave.

### PËRDITËSIMI

Përditësimi ose plotësimi i të dhënave të abonentëve është një proces mjaft i rëndësishëm, jo vetëm në aspektin ligjor, por edhe në drejtim të cilësisë së shërbimit dhe vendosjes së marrëdhënies kontraktore korrekte mes palëve. Me përditësimin/plotësimin e të dhënave, si numri i kontratës së furnizimit, kartën e identitetit, NIPTI, etj, evidentojmë qartë të dhënat e klientit, objektet që furnizohet me energji elektrike dhe shumangim pasaktësitë në trajtimin apo ofrimin e shërbimit. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE Sh.A) sqaron se, procesi i përditësimit të të dhënave nuk lindi si nevojë ditë e fundit, por në fillim të zbatimit të reformës, pasi u konstatuan pasaktësitë të dhënash për një pjesë të abonentëve tanë, të trashëguar në vite. Sikurse publiku është informuar, procesi i përditësimit nisi në shtator të 2015-s, dhe ka vijuar me kalimin e kohës, duke rritur sensibilizimin, përmes fushatave të ndryshme, e cila kulmoi në tetor 2016, me nisjen e intervistave derë më derë, bazuar mbi: Ligjin Nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike, miratuar me Vendimet Nr.108 dhe Nr.109,



datë 21.10.2011 të ERE dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 207, datë 16.03.2016, për "mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave".

### PROCESI

Procesi i përditësimit ka vijuar gjatë gjithë vitit 2017, ku pavarësisht intensifikimit të punës në terren, konstatohen ende abonentë që nuk kanë saktësuar të dhënat, kryesisht shtëpi të dyta, emigrantë, por edhe konsumatorë të cilët nuk

janë gjetur gjatë procesit të intervistimit. Për t'i sensibilizuar më tej, abonentët u njoftuan sërish në tetor 2017, përmes njoftimeve në media, rrjetet sociale, te zyrat e Kujdesit ndaj Klientit të OSHEE, dhe nga kontraktori. Për nga rëndësia që mbart saktësimi i të dhënave, është shumë i nevojshëm përfundimi i procesit në kohë, ndaj dhe abonentëve, sërish, iu është bërë thirrje sërish të kontaktojnë me numrat e telefonit.

### ADRESAT

- TIRANË**
1. Zyrat e "Çelësit", "Rruga e Kavajës", Qendra "Condor", Kati 3
  2. Zyrat e "Datech", mbropa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sol" (përballë Restorantit "Grepit Arië")
- DURRËS**
1. Rruga "Hafiz Podgorica", Nd. 16, Hyjja 2 ose ish-oxhaku i vjetër i NISH Goma
- ELBASAN**
1. Qendra Tregtare Dardanët, ngjitur me OSHEE
- FIER**
1. Tek Kullat e Omerit, Lagjia "15 Tetori"

### Pritet "Tirana approach"

#### BSH, plan të ri për kreditë me probleme

**B**anka e Shqipërisë do të hartojë këtë vit një paketë të re masash për uljen e kredive me probleme. Në strategjinë afatmesme të zhvillimit për periudhën 2018-2020, Banka Qendrore bën të ditur se brenda këtij viti do të hartohet një paketë e re, e quajtur "Tirana Approach". Kjo paketë do të synojë një ulje të mëtejshme të kredive me probleme dhe do të vijë tre vjet pas planit të masave që nisi zbatimin në vitin 2015. Paketa e tre viteve më parë ka dhënë gradualisht efekte pozitive në uljen e raportit të kredive me probleme, që në fund të vitit të kaluar zbriti në 14.3%, niveli më i ulët në shtatë vite e fundit. Përveç një pakete të re me qëllim uljen e kredive me probleme, Banka e Shqipërisë ka paralajmëruar një forcim të mbikëqyrjes ndaj subjekteve të licencuara për aktivitet në shërbime financiare. Sipas Bankës Qendrore, subjektet e licencuara dhe mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë duhet të jenë të përgatitura për një kuadër rregullativ me kërkesa më të rrepta e me detyrime të shtuara raportuese. Dokumenti evidenton se aktorë të caktuar të sistemit financiar po përballen me dinamika jo të favorshme, duke rishikuar modelet e tyre të biznesit apo dhe praninë e tyre në Shqipëri. Banka e Shqipërisë gjykon se ndryshimet e mundshme strukturore dhe konsolidimi i mëtejshëm i sektorit bankar, përmes bashkimeve apo përrithitjeve, shtron nevojën për monitorim dhe përzgjedhje të kujdesshme mbikëqyrëse.

### Inspektimi në portin e Durrësit

#### Gjikhuri: Porti, potencial për destinacion kroçerash

**M**inistri i Infrastruktura Damian Gjikhuri dhe kryebashkiaku Vangjush Dako zhvilluan një vizitë në portin e Durrësit. Ata panë nga afër terminalin e pasagjerëve ndërsa zhvilluan një bashkëbisedim edhe me drejtuesit e Portit për potencialin e zhvillimit. "Kryen një inspektim në Portin e Durrësit, duke parë se si funksionojnë kryesisht terminalin të cilat publiku e di që janë dhënë me koncesion, në disa raste të kritikueshme e nuk kemi pse ta fshëhim. Jemi këtu pasi në Portin e Durrësit do të kemi dy zhvillime shumë interesante. Së pari, këtë vit do të fillojmë projektin e shumë pritur të thellimit të thellimit dhe zgjerimit të portit që do të thotë se do ketë më shumë hapësirë për aktivitetet. Nga ana tjetër kemi filluar diskutimet edhe për mundësinë që porti i Durrësit të

kthehet në një destinacion kroçerash mesdhetare. Do të thotë që për periudhën e sezonit, këtu të ketë nga një kroçerë çdo ditë çka do jetë një nxitje ekonomike për portin dhe gjithë qytetin e Durrësit", nënvizoi ministri Gjikhuri. Më tej, ai sqaroi se Autoriteti Portual ka ndërmarrë hapat e

duhur për të aplikuar tek donatorët e bankat në lidhje me gjetjen e financimeve që do mundësojnë zhvillimin e mëtejshëm të portit. "Autoriteti portual ka aplikuar edhe për financime në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ku është parë me shumë prioritet financimi. Jam i bin-



dur se kombinimi i këtyre financimeve me interesin e

shtuar kroçerave do të ketë një rritje ekonomike më të madhe për portin dhe gjithë qytetin. Porti përgjithësisht ka pasur rritje ekonomike, pra janë shtuar volumet. Investimet në rrjetin rrugor apo edhe investimet që do të bëjnë në hekurudhë patjetër do të rrisin interesin Portit të Durrësit dhe do të rritet konektiviteti ku porti nuk ka përse t'i shërbejë vetëm Shqipërisë, por edhe vendeve të tjera të rajonit", theksoi Gjikhuri.

### Nis aksioni për ujën e pijshëm në Tiranë

#### Shoqërohet në polici një biznesmen



të Tiranës, u përgjendruan në zonën e Astirit dhe të Dajtit. Në zonën e Dajtit, u bënë 15 verifikime të hollësishtme në biznese të dyshuara për lidhje të paligjshme, si dhe 10 të tjera në zonën e Astirit. Nga kontrolli rezultuan katër raste të abuzimit me ujën e pijshëm, ku për një rast është kryer edhe shoqërimi i ishkelësve. Gjithashu, në dy linjat kryesore të

transmetimit, ajo dn 700 dhe dn 1000, që dalin nga impianti i Bovillës, u konstatuan gjithsej 14 lidhje të paligjshme. Aktualisht procesi i verifikimit të lidhjeve të paligjshme në këto tubacione po vijon ende. Ndërkohë, afati për vendosjen e lidhjeve të ligjshme dhe me kontratë me UKT është zgjatuar deri më 28 shkurt vetëm për konsumatorët familjarë.

Prokuroria kërkon 15 vite burg për Xhillarin dhe 8 vite heqje lirie në total për 2 zyrtarët e doganave

# Skandali me naftën virxhin, arrestohet Ardian Gjillari

## Biznesmeni i shumëkërkuar u prangos në Frankfurt të Gjermanisë

**TIRANË**

**B**iznesmeni Ardian Xhillari, i shpallur në kërkim për skandalin me naftën virxhin është arrestuar në Gjermani. Burime zyrtare për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se ai u kap mëngjesin e djeshëm në aeroportin e Frankfurtit, pasi emri i tij figuronte në listën e të kërkuarve ndërkombehtarë të Interpolit. Biznesmeni i naftës ishte ndaluar më 6 nëntor të vitit që shkoi në Zvicër, ndërsa është ende e paqartë përse ai ishte liruar. Të njëjtat burime pohuan se tashmë pritët të nisnin procedurat për ekstraditim të Xhillarit në Tiranë, ku do përballtet me akuzat e drejtësisë shqiptare. Nafta virxhin e kompanisë kompania "Tea Construcion & Petrol" hidhej në treg e papërpunuar dhe sipas prokurorisë, i është shkaktuar buxheti të shtetit një dëm prej miliona eurosh. Ndërsa dëmi i shkaktuar mjedisit dhe automjeteve të qytetarëve që janë furnizuar me naftë bruto, e cila është tregtuar si cilësore, është i pallogaritshëm. Po dje, Prokuroria e Tiranës kërkoi dënimin me 15 vite burg të Ardian Xhillarit; 5 vite për ish-zdrejtoreshën e Doganave Lule Njebza si dhe 3 vite për Mirarbër Teneqexhi, ish-drejtor i Doganës së



Biznesmeni Ardian Xhillari

**2 MLN EURO**  
Nga hetimet e kryera nga prokuroria ka rezultuar se në këtë skemë evazioni ishte përfshirë edhe numri dy i Doganës së asaj kohe, zonja Njebza, ndërsa në total kanë qenë 4.5 milionë litra naftë virxhin e nxjerrë në treg si naftë cilësore. Dëmi që i është shkaktuar buxhetit të shtetit arrin në 2 milionë euro.

Tiranës, të përfshirë në skandalin e futjes së naftës së papërpunuar në tregun vendës. Në total, organi i akuzës ka kërkuar 23 vite burg për tre të pandehurit. Biznesmeni Xhillari akuzohet për fshehje të ardhurash,

mospagim taksave dhe pastrim parash. Hetuesit kërkuan edhe heqjen e së drejtës për të drejtuar kompani për një periudhë 10-vjeçare. Në skemën e naftës

LISTA E ÇËSHTJEVE PENALE QË AKUZOHET XHILLARI	
1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Xhillari për veprën penale "Fshehja e të ardhurave" të parashikuar nga neni 180/3, dhe dënimin e tij me 7 vite burgim.	taksave dhe i tatimeve" dhe "Pastrim i produkteve të veprës penale" dhe dënimin e tij gjohë në masën 5.000.000 (pesë milionë) lekë.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Xhillari për veprën penale "Mospagimi i Taksave", të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vite burgim.	7. Deklarimin fajtor të të pandehurës Lule Njebza për veprën penale të "Shpërdorimit të Detyrës" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 5 vite burgim.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Xhillari për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga neni 287/3 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 15 vite burgim.	8. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh, për të pandehurën Lule Njebza.
4. Në zbatim të nenit 40 të Kodit Penal heqjen e së drejtës të ushtrimit të detyrave drejtuese për një periudhë prej 10 vitesh për të pandehurin Ardian Xhillari.	9. Deklarimin fajtor të të pandehurit Mirarbër Teneqexhiu për veprën penale të "Shpërdorimit të Detyrës" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim.
5. Në zbatim të nenit 55, paragrafi 3 të Kodit Penal, dënimin përfundimtar me 15 vite burgim.	10. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 3 vitesh, për të pandehurin Mirarbër Teneqexhiu.
6. Deklarimin fajtor të pandehurit "Tea Construcion & Petrol" për veprat penale "Fshehje e të ardhurave", "Mospagimi i	

virxhin ishin të përfshirë edhe punonjës të doganës. Nga hetimet e kryera nga prokuroria ka rezultuar se në këtë skemë evazioni ishte përfshirë edhe numri dy i Doganës së asaj kohe, zonja Njebza, ndërsa në total kanë qenë 4.5 milionë litra naftë virxhin e nxjerrë në treg si naftë cilësore. Pesë vite burg është kërkuar për ish-zdrejtoreshën e Doganave, Lule Njebza me akuzën e shpërdorimit të detyrës si

dhe 5 vite heqjen e së drejtës për ushtrimin e funksioneve publike. Në pretendencën e akuzës është përfshirë dhe kompania "Tea Construcion & Petrol" në pronësi të Xhillarit, ndaj të cilës për akuzën e fshehjes së të ardhurave dhe mospagimit të taksave është kërkuar dënimin me një gjohë prej 5 milionë lekësh. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një peri-

udhë prej 3 vitesh, për të pandehurin Mirarbër Teneqexhiu. Pjesë e kësaj skemë ka qenë dhe Mirarbër Teneqexhi, ish-drejtor i Doganës së Tiranës, ndaj të cilit rëndom akuzo e shpërdorimit të detyrës dhe për të është kërkuar dënim me 3 vite burg. Ky hetim ka zgjatuar për dy vite nga Prokuroria e Tiranës pas kallëzimit të tatimeve për zhdukjen e 4.4 miliona litra naftë virxhin.

### Ja si u vra fieraku Xhuliano Brahimllari

## Masakruan studentin shqiptar në Belgjikë, autorët e krimit dalin para gjykatës

**BELGJIKË** - Autorët e dyshuar të vrasjes së studentit shqiptar në Bruksel në vitin 2015 kanë dalë para Gjykatës Penale në Belgjikë. Vincent De Bruycker dhe Denis Nikolovska, njëri belg dhe tjetri maqedonas akuzohen për vrasjen dhe copëtimin e trupit të studentit shqiptar nga Dukasi i Fierit, Xhuliano Brahimllari, 22 vjeç në Koekelberg. Hetuesit kanë thënë se dy të arrestuarit janë autorët kryesorë të vrasjes së studentit shqiptar dhe për këtë edhe prova. "Ne kemi bërë një analizë të ADN së sharrës së gjetur dhe në bazë të rezultateve dëshmuam se bëhet fjalë për gjakun e




22-vjeçari i vrasë, Xhuliano Brahimllari

viktimës", kanë shpjeguar hetuesit për mediat belge. Gjithashtu, hetuesit kanë

thënë se karta SIM e telefonit të viktimës është aktive deri në orën 17:00, ndërsa vrasja ka ndodhur në orën 17:36 dhe telefonatat e fundit kanë qenë me dy të akuzuarit. Sipas hetimeve, dy personat të cilët ishin miq me viktimën kishin planifikuar ta vrasin shqiptarin dhe më pas ta masakrojnë duke i copëtuar pjesët e

trupit, pasi kishin blerë një hanxhar, një sharrë dhe mjete të tjera të nevojshme. Dyshohet se vrasja ka ndodhur për trafikun e kanabisit, pasi viktimja dhe dy të akuzuarit kishin një plantacion kanabisi. Paraditen e 9 qershorit të 2015-ës, punëtorët e komunës Jette në Belgjikë, në kufirin midis Jette dhe Wemmel bënë një zbulim tronditës. Ata gjetën një valixhe të madhe sportive, me ngjyrë të verdhë, e cila kishte brenda një bust njeriu, të cilit i mungonte koka, parakrahët dhe një pjesë e këmbëve. Pavarësisht se identifikimi i trupit të gjymtuar ishte i vështirë, në fund u konkludua se ai i përkiste shqiptarit 22-vjeçar Xhuliano Brahimllari, nga Dukasi i Patosit. Mësohet se ka qenë një prej xhaxhallarëve që e ka identifikuar nëpërmjet tatuazhit që kishte në trup i riu.



### Prostituta dhe kokainë, "Xhaxhai" nga Fieri drejtonte trafikun në Itali

**N**jë vajzë "nxirrte" 500 euro në natë, rreth 12.000 euro në muaj, ishte e mjaftueshme të "menaxhoje" tre për të arritur miliona euro. Kjo ka rezultuar nga hetimet që zbuluan dje një xhiro të madhe të prostitucionit të drejtuar nga shqiptarët dhe që çoi në burg 25 persona. Rreth tridhjetë vajza të përfshira, kryesisht shqiptare, rumune dhe moldave, midis 20 dhe 25 vjeç, të sjella në Itali të gjitha me premtimin për një punë. Secila kishte një vlerë në treg prej 100 euro për një natë. Shefi i organizatës, një person me iniciale K.M., me nofken "Xhaxhai", i cili me të afërmit e tij - të gjithë të ardhur nga qyteti i Fierit - i impononte protektorëve rumunë që "blinin" dhe menaxhonin vajzat, të paguanin qiranë e vendstacionimeve. "Lumi i parave ishte i pandërprerë", shpjeguan policët dhe shpesh paratë rriinvestoheshin në trafikun e kokainës dhe heroinës. Disa arrestime për drogë u kryen në flagrancë si pjesë e të njëjtit operacion: një kilogram heroinë u kap në Xhenova. Në një apartament, përveç 37 mijë eurove cash, agjentët kanë gjetur edhe një pistoletë 7.65 të mbushur dhe në këtë mënyrë shqiptarët drejtonin punën, si bosa të zonës, me shfrytëzuesit dhe me vetë prostitutat. Hetimet nisën nga denoncimi i një vajze të shfrytëzuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
Zyra përmbarimore "Besi 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë 12 shkurt 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek zyra përmbarimore do zhvillohet ankand i rre për shënjën e tre parcelave të ndodhura në L.13, ZK. 8518, Pllazh. Durrës e konkretisht pasarte nr 5854, vol 17, fq 2; 5856 fq 3; 5857, fq 4. Cdo titull ka sipasfaqen prej 600m<sup>2</sup> dhe mbli të rëndom një-marrveshje sipërmarje.

Çmimi filltar me të cilin hapet ankandi do të jetë:

1) për pasuritë 5854 është 57000 Euro; 2) për pasuritë 5856 është 57000 Euro; 3) për pasuritë 5857 është 198892 Euro.

P.s: Oryentuar/sugjertet që deshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit. Mësuar si garant për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet të jete e dëruar në BKT, nr legjorisë Samir Hoza PF (IBAN: AL37 2051 2094 4209 0002 0001 0001 0000)

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Telef ax: 052-22-4000

E-mail: besi.2010@pembarmarues.al; web: www.pembarmarues.al



**Lihet në burg nënkryetari i bashkisë, Ernolt Cani**

**Sherri me grushte e shkop bejsbolli mes PS e PDIU, policia "blindon" Bashkinë e Dibrës**

**DIBËR** - Një ditë pas përplasjes fizike me grushte, shqelma, karrige e shkop bejsbolli mes punonjësve të administratës së Bashkisë së Dibrës që përfaqësojnë PS-në dhe PDIU-në dhe që përfundoi me plagosjen e katër punonjësve, dje dyert e këtij institucioni ishin të mbyllura. Mëngjesin e djeshëm, në zyra nuk kishte asnjë zyrtar, ndërsa forcat policore kishin rrethuar godinën e bashkisë për të evituar një përplasje tjetër. Një ditë më parë në

**DEKLARATA E KRYEBASHKIAKUT**

Pas incidentit të rëndë në Bashkinë e Dibrës, kryebashkiaku Muharrem Rama tha se 30 persona, përfaqësues të PDIU-së, kanë hyrë në ambientet e institucionit që ai drejton duke ushtruar dhunë. Rama nuk ka mohuar që ish-in parajlmëruar largime nga puna, por tha se punonjësit e sjellë nga PDIU kanë performancë të dobët. Ndërsa, përmes një postimi në rrjetin social, Rama sulmoi ashpër PDIU-në, teksa ka shkruar se kanë të bëjnë jo me një parti politike, por me një bandë horrash.

pranga përfundoi nënkryetari i kësaj bashkie, Ernolt Cani dhe u shpall në kërkim Bekim Bitri, punonjës administrate, të dy nga radhët e PDIU. Ata akuzohen se



Policia pas incidentit në Bashkinë e Dibrës

dhunuan me mjete të forta 4 zyrtarë të bashkisë, midis tyre edhe drejtorin e ri të Burimeve Njerëzore, Drini Mataj. Njëri prej punonjësve, Hektor Cani qëndroi më gjatë në spitalin e Peshkopisë nën kujdesin e mjekëve. Kjo për shkak të plagëve dhe traumave nga

goditjet me shkop bejsbolli dhe shufra hekuri. Mësohet se Hektor Daci, truproja e kryetarit të bashkisë, ishte i pari që u bë objekt i sulmit dhe më pas drejtori i Burimeve Njerëzore në bashki, Drini Mataj. Ndërkaq, dje Gjykata e Shkallës së Parë në Dibër vendosi masën e sig-

urisë "Arrest me burg" ndaj nënkryetarit të Bashkisë, Ernolt Cani, i cili akuzohet për veprën penale "Goditje për shkak të detyrës".

Përplasjet nisën për shkak të kundërshtive të emërimit të drejtorit Mataj nga përfaqësuesit e PDIU, të cilët nuk pranojnë që këtë detyrë ta ketë një person nga jugu. Pas incidentit të rëndë, kryebashkiaku i Dibrës, Muharrem Rama deklaroi në një lidhje për "News 24" se një grup prej 30 personash, një pjesë e të cilëve të punësuar në Bashkinë Dibër nga radhët e PDIU-së, dhunuan një pjesë të stafit të bashkisë për lëvizjet brenda administratës. Qëllimi i dhunës, sipas tij, është të ushtrohet presion që bashkia të marrë vendime në funksion të interesave të tyre partiake.

"Me viktimitë kisha njohje prej 7 muajsh, na bashkonte pasioni për palestrën"

**"Se nxora unë në pritë Devi Kasmin, autori ishte me kapuç dhe me mjekër"**

*Mario Meshini: E qëlluan pas shpine sa zbriti nga makina*

TIRANË


**N**uk e nxora unë në pritë Devi Kasmin. Me Kasmin na bashkonte pasioni për palestrën. Vrasësi ka qenë mbi 180 cm i gjatë dhe me shumë mjekër. Ka pasur në kokë një kapuç të zi dhe të palosur te balli. Drejtuesin e motorit me të cilin u larguan autorët nuk e pashë". Kështu ka deklaruar gjatë marrjes në pyetje në polici, 25-vjeçari Mario Meshini, i cili u arrestua dy ditë më parë si bashkëpunëtor në ekzekutimin e 41-vjeçarit Kasmi. Ngjarje kjo e ndodhur mbrëmjen e së hënës në rrugën "Kongresi i Manastirit". Burime nga grupi hetimor dje bënë me se Meshini i qëndroi versionin se nuk ka lidhje me ekzekutimin e Devi (Dëfrim) Kasmit, duke dhënë detaje për autorin e atentatit, të cilin e kishte parë nga një distancë e afërt. Ndërkaq, mësohet se 25-vjeçari ka pranuar para oficerëve të policisë gjyqësore se i kishte dërguar mesazh viktimitë dhe se e priti për disa minuta derisa zbriti nga apartamenti ku banonte.

**DËSHMIA E MARIO MESHINIT**

25-vjeçari Meshini, i akuzuar për atentatin e bujshëm që ndodhi në kryeqytet, është paraqitur para uniformave blu në gjendje të tronditur psikologjike. Gjatë marrjes në pyetje, Meshini ka thënë se e njeh Devi Kasmin prej 7 muajsh, pasi i ka prezantuar kunati i vet. Gjatë dëshmisë, ai ka treguar detaje që ka mundur të vërë re në lidhje me autorët. "Me Devi Kasmin na bashkonte pasioni për palestrën". Meshini ka thënë se vrasja ka ndodhur para se ai të takohej me Devin dhe në momentin e ngjarjes, po qëndronte ende në motorin e tij. "Sapo zbriti viktima nga makina "Volk-



Viktima Devi Kasmi



I arrestuari, Mario Meshini



**AKUZA**

Mario Meshini, i cili u arrestua tri ditë më parë si bashkëpunëtor i autorëve të vrasjes së 41-vjeçarit Devi Kasmi akuzohet për "Vrasje me paramendim". Pas ngjarjes, policia deklaroi se dyshohet që 25-vjeçari e ka nxjerrë në pritë viktimitë dhe ka ndihmuar autorët të largohen. Shkak për këto dyshime janë bërë pamjet filmike nga kamerat e sekuestruara në vendin ku ndodhi atentati dhe mesazhi që Meshini i ka dërguar viktimitë pak para se të vritej.

sëagen' ngjyrë gri u qëllua pas shpine. Nuk ka pasur asnjë dialog mes vrasësit dhe viktimitë. Në momentin që u qëllua Kasmi, unë ngrita duart lart dhe thashë se nuk kisha lidhje me të. Dhe pastaj autori u largua me vrap drejt motorit", ka pohuar Mario. Gjithashtu, ai ka deklaruar se pak sekonda pas ngjarjes është larguar i

tronditur, pa prekur asgjë në vendngjarje. I arrestuari ka mohuar të ketë njohje me Domart Konjarin, i dyshuari kryesor për vrasjen e Devi (Dëfrim) Kasmit. Në vendin e ngjarjes, policia ka gjetur edhe dy pistoletat të markës "Glock" 9 mm, një prej të cilave ka qenë e kromuar. Edhe për këto, Meshini ka mohuar të ketë lidhje duke

sqaruar se nuk mbante armë. Ndërkohë, policia po vijon intensivisht hetimet për personat që ekzekutuan 41-vjeçarin, baba i dy fëmijëve. Asnjë prej autorëve nuk është identifikuar nga uniformat blu në pamjet filmike që ata kanë. Pavarësisht se policia është shprehur se porositësi i dyshuar për këtë vrasje është Domart Konjari, nuk ka

bërë asnjë provë publike që e lidhin atë me atentatin ndaj Devi Kasmit. Kamerat e sigurisë i kanë ndihmuar hetuesit e çështjes vetëm për të rindërtuar mënyrën si ka ndodhur krimi, por jo për të identifikuar personin që e qëlloi. Dy ditë më parë, gazetari Artan Hoxha tha në "News 24", se mesazhi i gjetur në celularin e viktimitë ka bërë që të identifikohet shtetasi Mario Meshini, i cili u arrestua nga policia pas ngjarjes. Ka qenë pikërisht Mario Meshini, personi që i ka kërkuar Devi Kasmit të takohen. Por sapo ky i fundit ka dalë nga makina, janë vënë në lëvizje dy autorët e ngjarjes, të cilët janë afruar me një motor. Njëri prej tyre ka qëlluar me armë drejt Devi Kasmit, i cili nuk ka mundur të nxjerrë armën e tij, duke qenë se lëvizte i armatosur.

**SHKURT**

**Arrestohet shoferi i dehur që transportonte nxënës**

**TIRANË** - Policia Rrugore e Tiranës ka ndërmarrë një sërë masa për sigurimin e transportit të nxënësve të shkollave në kryeqytet, duke kaluar në "sitë" automjetet që bëjnë transporte të tilla. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se nga kontrolli i ushtruar në disa zona në Tiranë, ka rezultuar se disa automjete të transportit publik transportonin fëmijë e nxënës në shkelje flagrante të rregullave të qarkullimit rrugor, si pa kontroll teknik, pa licencë transporti, pa vendosur rripin e sigurimit, pa leje qarkullimi, nën ndikimin e alkoolit apo në gjendje të dehur. etj. Një rast i tillë flagrant rezultoi ai i një drejtuesi të një autobusi shkolle në zonën e Unazës së Re, ku transportonte nxënës, drejtonte mjetin pa leje qarkullimi, pa kontrollin teknik të mjetit, pa certifikatë transporti për nxënës, në gjendje të dehur, si dhe debitor, pasi ishte ndëshkuar edhe disa herë të tjera për mospërdorim të rripit të sigurimit. Nga verifikimi me aparatit drager ka rezultuar se 56-vjeçari Isuf B. drejtonte autobusin në gjendje tej mase të dehur: Në këto kushte është bërë arrestimi i tij për veprën penale të "Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur".

**Vidletë dyqane e banesa, prangoset 36-vjeçari**

**TIRANË** - Një 36-vjeçar nga Tirana ka përfunduar në pranga, pasi akuzohet për disa vjedhje në zona të ndryshme në kryeqytet. Bëhet fjalë për Pirent Kanon, i dënuar dy herë më parë për vjedhje. Sipas bluve, ai u kap, pasi më datë 13.01.2018 dyshohet se në rrugën "Kongresi i Lushnjës" ka vjedhur një shumë lekësh në një supermarket në pronësi të shtetasës B. N., 41 vjeçe. Gjithashtu, në vijim të veprimeve hetimore rezultoi se ky shtetas dyshohet edhe si autor i 5 vjedhjeve të tjera në lagje të ndryshme të Tiranës.

## EMIGRANTET SHQIPTARE VIZAT

Cilat janë kategoritë e vizave që përfitohen nga familjarët dhe të afërmit

# Si të aplikoni për bashkim familjar në Amerikë

Ambasada: Mund të pritët për vite me radhë për intervistën



Voltiza Duro

Qendra Kombëtare e Vizave në Shtetet e Bashkuara përcakton se për intervistat e vizave imigruese e për disa kategori vizash aplikantët duhet të presin me vite. Kjo është bërë me dije ditën e djeshme në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të ambasadës amerikane. "Për disa kategori vizash (fëmijët e martuar dhe vëllezërit e motrat) aplikantët duhet të presin me vite përpara se çështjes së tyre t'i vijë radha për intervistë", citon ambasada. Peticionet në pritje, veçanërisht kategoritë numerikisht të kufizuara, mund të qëndrojnë në Qendrën Kombëtare të Vizave (NVC) për shumë vite. Ambasada bën me dije se ekzistojnë kufizime ligjore për numrin e vizave të kategorive me preferencë, bazuar në familje që mund të lëshohen çdo vit. Në këto kategori, listat e pritjes përcaktohen duke u bazuar në datën prioritare, e cila është data kur është dorëzuar peticioni i aplikantit. Kurse datat Cut-off, të vendosura nga zyra e vizave, përcaktojnë se kur peticionit të kandidatit i vjen radha e shqyrtimit për vizë. Peticioni i të interesuarve mund të bëhet aktual, pra gati për procesim të mëtejshëm, vetëm kur data Cut-off në kategorinë e vizës të ketë përparuar në datën prioritare. "As ambasada, as Qendra Kombëtare e Vizave nuk mund të parashikojnë se kur do të mund të bëhet aktual rasti juaj. Ju duhet të monitoroni lëvizjen e datës Cut-off në publikimet e zyrës së vizave për të mësuar se kur rasti juaj do të jetë aktual", - thekson më tej ambasada amerikane në Tiranë.

### KATEGORITË E VIZAVE

Dy kategoritë e grupeve të vizave që përfitohen nga familja, të afërmit e menjëhershëm dhe preferencat familjare, janë dhënë sipas dispozitave të ligjit të imigracionit të Shteteve të Bashkuara. Vizat imigruese bazuar në familjarë të drejtpërdrejt (të palimituarit) bazo-



Ambasada amerikane

### LLOJET E VIZAVE

**Bazuar në të afërm të menjëhershëm:**

- IR-1: Bashkëshort/e e qytetarit amerikan;
- IR-2: Fëmijë nën moshën 21 vjeç i qytetarit amerikan;
- IR-3: Jetim i birësuar jashtë SHBA nga një qytetar amerikan;
- IR-4: Jetim që do të birësohet në SHBA nga një qytetar amerikan;
- IR-5: Prind i një qytetari amerikan, i cili është të paktën 21 vjeç.

**Bazuar në preferencën familjare:**

- Preferenca e parë familjare (F1): djemtë dhe vajzat e pamartuar të qytetarëve amerikanë dhe fëmijët e tyre, në qoftë se kanë;
- Preferenca e dytë familjare (F2): bashkëshortët/et, fëmijët minoronë, dhe djemtë dhe vajzat e pamartuar (mbi 21 vjeç) të përtheshëm të ligjshëm. Të paktën 27 përqind e të gjithë vizave të kësaj kategorie janë për bashkëshortët/et dhe fëmijët; pjesa e mbetur u kalohet djemve dhe vajzave të pamartuar;
- Preferenca e tretë familjare (F3): djemtë dhe vajzat e martuar të qytetarëve amerikanë, si dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre;
- Preferenca e katërt familjare (F4): vëllezërit dhe motrat e qytetarëve amerikanë dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre, kur qytetarët amerikanë janë të paktën 21 vjeç.

preferencën familjare janë: preferenca e parë familjare (F1) që përfshijnë djemtë dhe vajzat e pamartuar të qytetarëve amerikanë dhe fëmijët e tyre, në qoftë se kanë; ndërsa preferenca e dytë familjare (F2) është për bashkëshortët/et, fëmijët minoronë, dhe djemtë dhe vajzat e pamartuar (mbi 21 vjeç) të përtheshëm të ligjshëm. Ndërkaq, preferenca e tretë familjare (F3) nënkupton djemtë dhe vajzat e martuar të qytetarëve amerikanë, si dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre; në një kohë që preferenca e katërt familjare (F4) përfshin vëllezërit dhe motrat e qytetarëve amerikanë dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre. Në faqen zyrtare të ambasadës theksohet se gjyshërit, tezet dhe hallat, dajat dhe xhaxhallarët, vjehrrit dhe vjehrra, si dhe kushërinjtë nuk mund të bëjnë bashkim familjar.

### PROCEDURA

Të gjithë të interesuarit duhet të ndjekin hapat e përcaktuar për të aplikuar për një vizë imigrimi për një të afërm të menjëhershëm ose preference familjare. Marrëdhëniet familjare dhe llojet e veçanta të punësimit që mund të sponsorizohen për qëllime të imigracionit bazohen në ligjet e emigracionit të SHBA, të cilat përcaktojnë si kategoritë e lejuara të vizave të emigrantëve, kërkesat për përshatshmëri dhe procedurat. Ndërsa shumë marrëdhënie familjare mund të sponsorizohen, disa marrëdhënie familjare nuk mund të sponsorizohen për të emigruar në Shtetet e Bashkuara. Për të emigruar në bazë të punësimit, si punëdhënësi dhe punonjësi i ardhshëm duhet të plotësojnë disa kushte. Kërkesa e paraqitur nga sponsori amerikan duhet të aprovohet nga USCIS para se aplikanti të fillojë hapat në procesin e aplikimit për vizë emigrimi. Për të aplikuar për një vizë emigrimi, një shtetas i huaj duhet të sponsorizohet nga një i afërm i shtetasve të SHBA, rezident i përtheshëm i ligjshëm i SHBA-së ose nga një punëdhënësi i ardhshëm dhe të përfitojë një peticion të miratuar. Një hap i parë në proces është sponsori që paraqet një peticion me US Citizenship and Immigration Services (USCIS).

## Malaj: Ende pa përgjigje zyrtare nga pala greke

Rreth 20 mijë emigrantë shqiptarë në Greqi rrezikojnë të mbeten të paligjshëm

Përej më shumë se dy javësh, emigrantët shqiptarë në Greqi rrezikojnë të ngelen të paligjshëm për 5-6 muaj pasi u përfundon leja e qëndrimit. Rreth 20 mijë shqiptarë që jetojnë në shtetin helen nuk mund të aplikojnë për rinovim të lejeve, pasi sistemi kompjuterik ka dalë jashtë funksionit e kjo ka bllokuar të gjithë punën. I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", Fatos Malaj, ndërmjetës ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit dhe drejtues i organizatës së emigrantëve "Arogji - Përkrahja" tregon se deri më tani ende nuk ka një reagim zyrtar nga pala greke, pavarësisht kërkesës që i është bërë. "Po preken rreth 20 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi, të cilët rrezikojnë të ngelen të paligjshëm nga 5 deri në 6 muaj. Po e njëjta gjendje paraqitet edhe në qendrat e marrjes së nënshtetë-



Foto ilustruese

sisë. Organizata "Arogji" i dërgoi një kërkesë Ministrisë së Politikës së Emigracionit, ku i kërkuam që të ndryshohet urgjentisht gjendja e krizuar, si dhe disa propozime për të dalë nga kjo situatë", - tregon Malaj. Në kërkesën drejtuar palës greke, kërkohet nxjerrja e një urdhri të ministrit, ku t'u jepet shtyr-

je afati për një gjashtëmuajor të gjitha lejeve të qëndrimit, pa përjashtim. "Kemi hyrë në javën e tretë që në shërbimet e shtetasve të huaj dhe emigracionit, por edhe të nënshtetësisë, nuk funksionon absolutisht asgjë, për shkak të prishjes së sistemit kompjuterik. I bëjmë thirrje Ministrisë së Politikës së

Emigracionit dhe çdo instance kompetente që të kujdeset për të gjithë këta emigrantë që po jetojnë në një regjim pasigurie të plotë dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'u trajtuar me dinjitet njerëzor çështja e lejeve të tyre të qëndrimit", - nënvizohet në kërkesën e Organizatës së emigrantëve "Arogji - Përkrahja". Kjo e fundit bën thirrje gjithashtu që drejtoritë e shtetasve të huaj dhe emigracionit të mbështeten menjëherë me personel shtesë si dhe të miratohet shpërblymi i punës jashtë orarit për nëpunësit. Njëkohësisht me publikimin e kësaj kërkesë, organizata e emigrantëve shqiptarë në Greqi, "Arogji" u ka kërkuar edhe shoqatave të tjera që t'i drejtohen me një kërkesë të ngjashme Ministrisë së Politikës së Emigracionit.

qytetar amerikan; e viza IR-5 është për prindin e një qytetari amerikan, ky i fundit të paktën 21 vjeç. Vizat imigruese bazuar në preferencën familjare (të limituarit) janë për lidhjet familjare më specifike, më të largëta,

me një qytetar amerikan dhe disa lidhjet të përcaktuara me banorin e përtheshëm të ligjshëm. Për emigrantët me preferencë familjare ekzistojnë kufizime numerike për çdo vit fiskal. Kategoritë e vizave imigruese bazuar në

hen në një lidhje të ngushtë familjare me një qytetar amerikan, që përcaktohen si i afërm i drejtpërdrejtë. Llojet e vizave bazuar në të afërm të menjëhershëm përfshijnë vizën IR-1 pra bashkëshort/e e qytetarit ameri-





FORMULARI A1

Maturantët e vitit mësimor 2017-2018, do e plotësojnë formularin A1 në shkollat e arsimit të mesëm ku ndjekin studimet. Maturanti/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në portalin qeveritar e-albania...



FORMULARI A1Z

"Plotësimi i formularit A1Z, nga maturantët e viteve të mëparshme (kandidatët), bëhet në shkollat ku ata kanë kryer arsimin e mesëm të lartë, ose në shkollën e përcaktuar nga KMSH-ja sipas vendbanimit, nëse shkolla e mesme që kanë përfunduar, është mbyllur", - bëhet me dije në rregullore.

Urdhri 672 i MASR: Ja cilët kandidatë kanë të drejtë të hyjnë në provime

Miratohet rregullorja e Maturës Shtetërore 2018

Voltiza Duro

Të gjithë nxënësit që ndjekin studimet në vitin e fundit të shkollës së mesme, tashmë mund të njihen me Rregulloren për Zhvillimin e Maturës Shtetërore 2018 në Republikën e Shqipërisë. Kjo e fundit ka marrë miratimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë pas firmosjes së Urdhrit nr.672 nga vetë ministria Lindita Nikolla. Sipas rregullores, provimet e maturës zhvillohen vetëm me shkrim për të gjithë ata që kanë mbyllur me sukses vitin e fundit të shkollës së mesme, ndërkohë nxënësit që kanë marrë më pak se 20% të pikëve të testit konsiderohen mbetës. Në testimet e Maturës Shtetërore 2018, kanë të drejtë të hyjnë maturantët që kanë bërë plotësimin e formularit A1 apo A1Z që do të miratohen nga MASR brenda datës 9 mars të këtij viti. Me tej, Ministria e Arsimit do të publikojë në portalin e saj si dhe në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, formularët A1 dhe A1Z si dhe udhëzuesin e plotësimi online të tyre brenda datës 12 mars 2018-të. Po në këtë afat, do të shpallet edhe udhëzuesi i plotësimi online të bazës së të dhënave nga KSHMSh-ja në portalin "Matura Shtetërore" si dhe në portalin "Maturanti". "Maturanti/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në Portalin Qeveritar e-albania në periudhën 15-30 mars 2018, dhe më pas, në portalin "Matura Shtetërore 2018", në periudhën 26 mars-10 prill 2018, sipas një plani kalendar të publikuar nga QShA-ja. Në periudhën 11-20 prill 2018, Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore dhe Komisioni i Maturës Shtetërore pranë drejtorive apo zyrave arsimore plotësojnë online bazën e të dhënave me fushat përkatëse, sipas udhëzuesit të dërguar nga QShA-ja.", citohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2018-të. Në të gjitha ato raste kur të dhënat mund

Afatet e plotësimit të formularëve A1 dhe A1Z

RREGULLORJA Në nenin 15 të rregullores theksohet se kandidatët nuk lejohen të ripajin provimet me zgjedhje, nëse në maturat e viteve të mëparshme, rezultatet janë më të ulëta se 4.50 e në rastet kur maturantët e kanë dhënë më shumë se një herë një lëndë apo ato me zgjedhje, iu njihet vetëm rezultati i fundit.



Foto ilustruese

të mund të kenë gabime, maturantët kanë mundësinë që të dërgojnë vërejtjet e tyre për pasaktësitë e deri në 30 prill 2018-të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme në sistemin.

PLOTËSIMI I FORMULARËVE Maturantët e vitit mësimor 2017-2018, do e plotësojnë formularin A1 në shkollat e arsimit të mesëm ku ndjekin studimet. "Plotësimi i formularit A1Z, nga

maturantët e viteve të mëparshme (kandidatët), bëhet në shkollat ku ata kanë kryer arsimin e mesëm të lartë, ose në shkollën e përcaktuar nga KMSH-ja sipas vendbanimit, nëse shkolla e mesme që kanë përfunduar, është mbyllur", - bëhet me dije në rregullore. Këta kandidatë duhet të dorëzojnë

pranë KMSH-së një kopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë; vërtetimin me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, me fotografi; certifikatën e Maturës me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme. Ndërkohë, plotësimi i formularit A1Z nga kandidatët që kanë përfunduar shkollën e

mesme jashtë vendit, bëhet në shkollat e përcaktuara nga KMSH-ja e DAR/ZA-së. Me tej në rregullore theksohet se për shkollat profesionale dhe shkollat e mesme të orientuara, në rastet kur kandidatit ka fituar dëftesën e pjekurisë, si provime të detyruara njihen: letërsia dhe matematika (nëse janë

SHKOLLAT PROFESIONALE Në rregullore theksohet se për shkollat profesionale dhe shkollat e mesme të orientuara, në rastet kur kandidatit ka fituar dëftesën e pjekurisë, si provime të detyruara njihen: letërsia dhe matematika (nëse janë dhënë dhe janë fituar); ose një ose dy nga provimet në mungesë të tyre, sipas planit mësimor të shkollës.


dhënë dhe janë fituar); ose një ose dy nga provimet në mungesë të tyre, sipas planit mësimor të shkollës. Gjithashtu, në nenin 15 të rregullores theksohet se kandidatët nuk lejohen të ripajin provimet me zgjedhje, nëse në maturat e viteve të mëparshme, rezultatet janë më të ulëta se 4.50 e në rastet kur maturantët e kanë dhënë më shumë se një herë një lëndë apo ato me zgjedhje, iu njihet vetëm rezultati i fundit.

DITA E TESTIMEVE Maturanti paraqitet në qendrën e provimit, 1 orë e 30 minuta përpara fillimit të provimit. Në momentin e paraqitjes në mjediset e provimit, duhet të ketë dokumentin e identifikimit dhe mjetet e nevojshme, si: laps, vizore, kompas, makinë të thjeshtë llogaritëse. Maturantët që dorëzojnë testin, firmosin për dorëzimin e tij në listën që disponon AP-ja. Kandidatët që dorëzojnë testin e provimit përpara kohës së përcaktuar, nuk mund të dalin nga qendra e provimit, para kohës së përfundimit të të provimit.

Ja nivelet e studimit ku mund të kandidoni

Bursa në universitetet më të mira në Rusi, 1 marsi afati i fundit i aplikimit

Data 1 mars është afati i fundit i aplikimit për bursë në universitetet e Rusisë, për të gjithë shqiptarët që dëshirojnë të ndjekin studimet e larta në këtë shtet. Ky lajm është bërë me dije ditën e djeshme nga ambasada ruse, e cila thekson se opionet e mundshme janë studimet bachelor, master,



doktoraturë, si edhe programe të tjera. "Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë për fillimin e aplikimeve për përfitimim falas të bursave studimi për në universitetet më të mira ruse për vitin mësimor 2018-2019. Akordimi i bursave për të rinjtë shqiptarë realizohet në kuadër të programit të përvitshëm të

Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Rusisë dhe Agjencisë Federale të Bashkëpunimit Humanitar Ndërkombëtar "Rossotrudnichestvo", citohet në njoftimin e ambasadës. Ky konkurs do të ofrojë mundësinë e studimit falas në institucionet kryesore të arsimit të lartë të Rusisë për një

gamë të gjerë specializimesh. Në rast se asnjë nga organizatat arsimore të paraqitura në anketë, për një arsye apo një tjetër, nuk e përzgjedh pretendentin e huaj si studentin e tyre të ardhshëm, e drejta e përcaktimit përfundimtar të vendit të arsimimit të tij i rezervohet Ministrisë së Arsimit të Rusisë.

NJE RRUGETIM DREJT LAVDISË

# Një jetë në rrugën e Zotit Një jetë në rrugën e kombit Një jetë, shkëlqim dhe lavdi!

Ferdinand Samarxhi, Mjeshër i Madh



*Presidenti Meta dekoron kreun e BFI-së, Sulejman Rexhepi me titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut"*

*Njerëz që punojnë për kombin, Zotin, gjithmonë do të jenë lavdi dhe shkëlqim i gjenezës shqiptare*

Bashkësia Islame e Maqedonisë, që në pavarësimin e saj, do të udhëhiqet për herë të parë nga një hoxhë atdhetar shqiptar, i njohur edhe më herët si "shqiptar i papërshatshëm" për politikën maqedonase. Ky Institucion do të jetë ndër promotorët kryesorë të formimit të partisë së parë shqiptare në Maqedoni (Partisë për Prosperitet Demokratik) si dhe do të



Që të gjithë, që nga Kardinali, kryegjyshi botëror e klerikë të besimeve të ndryshme të Ballkanit urojnë si vëllezër në Zotin Sulejman ef Rexhepin për dekoratën e lartë "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut"

Në rrugetimin e jetës, të punës, të një gazetari për gati afro gjysmë shekulli përjetohen dhe përcillen shumë ngjarje, episode, ndodhi që fiksohen në celuloid. Shumë prej tyre, të prekshme, motivuese, treguese për historinë dhe kohët e tyre.

Ishin ditët e para të agut të demokracisë dhe në një ditë të bukur të historisë së tyre do të takojë bariumin e urtë të grigjës Don Ernest Troshani, bariumin e dhembshur që edhe pse kishte vuajtur vite të tëra në burgjet e territ, vuante shumë, se e donte shumë grigjën e tij. Ishin vite kur terri ishte përhapur si një epidemi dhe bariumi i varfër e i vuajtur Don Ernest Troshani do të përkëdhelte me dhimburi e dashuri çdo anëtar të grigjës. Lumnimin i Jezu Krishtit do t'i shpëtojë të gjithë, grigjën e tij. E zëri i bariumit të urtë në altar u përhap dhe kumbosi si një simfoni pa mbarim, si një sakrificë i dashurisë hyjnore për të gjithë njerëzit që e kishin ëndërruar atë. E bariumi tonë me grigjën e tij gëzoi ditët e u rrit dhe zëri i tij në altarin e shenjtë tashmë nuk flet dhe nuk thërrret më vetëm për grigjën e tij por, për gjithë kombin, për gjithë galdinën e madhe të kombeve. Bariumi im që unë e desha dhe e përcolla për çdo ngjarje, për çdo sakrificë të tij tashmë është kardinali imë, tashmë është edhe më shumë jo vetëm për kombin tonë por për gjithë krishterimin, për gjithë njerëzit e kësaj bote. Princ Botëror i Kishës. E kështu shkruaj historinë çdo ditë me të, tashmë jo me një bari të thjeshtë të vuajtur të dashur por me Kardinalin tonë, Princ Botëror të Kishës Botërore.



Presidenti i Shqipërisë i dorëzon dekoratën kryetarit të BFI, S.ef Rexhepit

Njeriu i madh për të cilin unë kisha dëgjuar do të më emociononte që në takimin e parë. U njohëm dhe u miqësua si pjesëmarrës në një kongres botëror që mbajet për besimin islam në Washington. Që nga ajo ditë miqësia gjithnjë e më shumë rritet për të, gjithnjë e më shumë figura e tij rritej para të tjerëve për ideale që përcillte për kombin, për atdheun, për zotin, për islam, identitetin kombëtar. Ky ishte Reisul Ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepi për të cilin unë dua të tregoj në pak rreshta jetën, punën, përkushtimin, dashurinë që ushqen ai, për kombin, për atdheun, për Shqipërinë, për besimin, rrugën e tij, indinjitetin dhe frymën kombëtare të islamit.

Në një ceremoni zyrtare, në presidencën e shtetit shqiptar, njeriu me të cilin unë u njoha, nuk u ndava kurrë, u vlerësua, me dekoratën më të lartë "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut". Duke punuar dhe mësuar shumë, duke qenë shumë pranë tij, tregimi im për të do të rrjedh si një dashuri e veçantë për njerëzit që unë njoha, u rrita, luftova dhe punova bashkë me to për rrugën e zotit, për dashurinë që lindën dhe ushqyen ata tek të gjithë njerëzit, për dashurinë, bashkëjetesën harmoninë dhe tolerancën fetare që promovojnë dhe përqan ata.

Që në fillim dua të them se arritjet dhe sukseset e Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë janë të lidhura ngushtë me jetën, punën, përkushtimin, devocionin e Reisul Ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepi.

Jo rastësisht, historia jonë kombëtare ka rezeruar vend të ndritshëm për shumë personalitete nga komuniteti i klerikëve myslimanë, të cilët kanë lënë gjurmë të përhershme në sferën e angazhimeve gjithëkombëtare. Pavarësimi i Maqedonisë më vitin 1991, logjikisht do ta përshpejtonte edhe pavarësimin e Bashkësisë Islame të Maqedonisë, e cila, që në start do të bëhet një problem i patejkalueshëm për politikën sa diskriminuese aq dhe shoviniste të qeverisë maqedonase e cila, ndonëse tashmë e pavarur, asesi të shkëputej nga ndikimi i politikave serbe antishqiptare.

jetë iniciues i shumë lëvizjeve të reja kombëtare në Maqedoni.

Në fillimet e pluralizimit në Maqedoni, qarqet të ndryshme shohene po planifikonin ndryshim të historisë dhe përvetësim të ngjarjeve të rëndësishme, me çka, shumica absolute e myslimanëve të vendit, pra shqiptarët, tentojnë të paraqiteshin si të ardhur, apo si uzurpatorë të Maqedonisë. Me iniciativën këmbëngulëse të Kryetarit të BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, përkundër shumë kërcënimeve të pushtetit të atëherëshëm maqedonas, Bashkësia Islame e Maqedonisë do të jetë organizatore e Simpoziumit Gjithëkombëtar; në të cilin do të tubohen qindra shkencëtarë shqiptarë nga e gjithë bota dhe ku do të debatohet mbi lashtësinë dhe autoktoninë e shqiptarëve të Maqedonisë. Natyrisht që ky simpozium do të bëhet mburojë e pathyeshme karshi përpjekjeve dhe strategjive të pseudo-akademikëve maqedonas për ta minimizuar rolin dhe peshën e shqiptarëve myslimanë në këto troje.

Bashkësia Islame e Maqedonisë ngriti zërin kombëtar nëpër qarqe e forume të ndryshme ndërkombëtare kundër shumë padrejtësive që po u bëheshin shqiptarëve në hapësirat e ish-republikave jugosllave. Kësaj, Bashkësia Islame e Maqedonisë, si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm, i kishte dhënë vetes obligim të shpalosë nëpër botë edhe shtetësimet kombëtare të shqiptarëve. Në këtë periudhë, shumë shërbime e shoqata të ndryshme, nën pretekstet e besimit si dhe të humanizmit, do të përpiqen që ta demtojnë kauzën shqiptare në rajon, por Bashkësia Islame e Maqedonisë, respektivisht, kryetari i saj H. Sulejman ef. Rexhepi, nuk do të lëshojë të Lindjes së Mesme, për përfaqësues diplomatikë, kongrese, universitete e akademitë të shteteve turko-arabe ku nuk do të ngrejë zërin kundër këtyre tentativave antiislame, që mbi të gjitha synonin demtimin e kauzës kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi e në Lugjinë e Preshevës.

Një nga politikët kryesorë të BFI-së ka qenë avancimi i zhvillimit arsimor të shqiptarëve myslimanë nga niveli i mektebeve në shkollim të mesëm dhe të lartë. Kësaj, në periudhën prej një dekadë e gjysëm, BFI-ja do të bëhet edhe me Medresenë e vet "Isa Beu" por edhe me Fakultetin e Shkencave Islame. Në këtë projekt strategjik, nuk ishte në plan të parë vetëm kultivimi i kuadrin arsimor shkencor islam, por mbi të gjitha, kuadrin shqiptar të dalë nga institucionet shkollore autoktone, ku teologët do të kaliteshin në mesin e një tradite, të një kulture, të një filozofie të të jetuarit dhe të logjikutarit ashtu siç ishin zhvilluar me shekuj në trevatona autoktone.

Ishë angazhimi permanent i Kryetarit të Bashkësisë Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi, për sigurimin e

sa më shumë kuota dhe bursave për të rinjtë tanë nëpër fakultete të ndryshme në qendrat universitare gjithandej Lindjes së Mesme dhe më gjerë.

Në historinë e Universitetit të parë në gjuhën shqipe në Maqedoni, Universitetit të Tetovës, emri i Bashkësisë Islame si dhe i Kryetarit H. Sulejman ef. Rexhepi, do të mbeten të gdhendura në historinë e artë të kombit tonë, pasi kontributi i BFI-së dhe i efendi Rexhepit në hedhjen e hapave të para të Universitetit të Tetovës është i pamohueshëm. Emri i efendi Rexhepit është në mesin e nismëtarëve të parë të këtij projekti kombëtar. Ligjëratat e para dhe rektoratit i parë i këtij Universiteti do të zhvillohen pikërisht në pronat e Bashkësisë Islame të Maqedonisë, madje në çastet vendimtare kur kundër këtij Universiteti ishte ngritur tërë aparat i dhunës shtetërore maqedonase. "Po të mos ishte Sulejman Rexhepi nuk do të ishte Universiteti i Tetovës, deklaroi dhe thekson Prof. Fadil Sulejmani, dekani i parë i UT, në tubimin e mbajtur në Bogovinjë të Tetovës".

Bashkësia Islame e Maqedonisë, Kryetari i këtij Institucioni, efendi Rexhepi, përveç që do të flasë për pozitën dhe politikën diskriminuese shtetërore kundër myslimanëve (pra, të shqiptarëve) të Maqedonisë, do t'i sensibilizojë opinionin dhe për pasojë të një lufte gjithëballkanike nëse nuk do të realizohet sa më parë pavarësia e Kosovës si dhe një luftë eventuale serbo-shqiptare në Kosovë ku mund të përfshite edhe Maqedoninë. Atëkohë, zëri artikulesh dhe politikave kombëtare shqiptare në hapësirat e ish-Jugosllavisë ishte LDK-ja e Ibrahim Rugovës. Dhe, efendi Sulejman Rexhepi, jo nëherë ka arritur që të organizojë takime të kërreut të kësaj Partie me burra shteti dhe diplomatë të huaj pikërisht në selinë e Kryetarit të BFI-së.

Duke qenë në rrjedha dhe i informuar nga qarqet kombëtare e ndërkombëtare për çaste e vështira që mund të imponohen si pasojë e politikave shoviniste e raciste të Serbisë milloshvegjane, Bashkësia Islame e Maqedonisë me kohë kish marrë të gjitha masat që në rast nevojë të jetë në krye të detyrës konform organizimit të saj. Prandaj, në një afat rekord i sistemi mbi 20 mijë boshnjakë të ikur nga agresioni serb në Bosnjë-Hercegovinë. Të gjithë këta myslimanë i sistemoi nëpër shtëpitë shqiptare në Maqedoni, duke i mbajtur pa kurrfarë problemi me muajt të tërë. Natyrisht, duke pasur teologët e vet të përfshirë edhe në strukturat e celulave të para të armatosura të shqiptarëve të Kosovës, e priste ditën kur Kosova do të gjendej nën një presion të tmerrshëm të pastrimit etnik. H. Sulejman Rexhepi bashkë me teologët e vendit, tashmë e kishin sensibilizuar tërë opinionin shqiptar të Maqedonisë që, të gjitha shtëpitë, dhe, nëse e do nevoja edhe të gjitha xhamitë e vendit, të hapnin dyert si dhe të përgatiteshin për një valë të madhe të refugjatëve nga Kosova. Kështu dhe ndodhi, BFI-ja arriti që të strehojë dhe të



Sulejman efendi Rexhepi: Një jetë e tërë, një përkushtim për rrugën e Zotit, besimin, integritetin kombëtar, nga një bari i thjeshtë, sot një lider i madh, një koloz i shpirtit të Zotit dhe i kombit





## PORTRET

# Ramë Lahaj

## Tenori që bën krenar Placido Domingon: Sonte jam Alfredo i Traviatës në Paris

Fatmira Nikolli

**E** kam njohur Ramë Lahajn, kur shumë vite më parë, mbase tetë, ai ishte i ftuar te "Tre tenorët" e Shqipërisë. Atëherë, kishte pak kohë që kishte mbaruar Akademinë e Arteve në Tiranë, ishte kthyer në Kosovë, dhe prej atëherë, sa po hidhte hapat e parë në skenën ndërkombëtare. U ritakua me "Tre tenorët" e Kosovës, dy vjet më parë. Rama, e kishte humbur djaloshin që sa ka mbaruar studimet dhe vinte me potencën e një zëri që dëgjohej në shumë skena. Vendin e ish-studentit të Tiranës, tanimë e kish zënë tenori i teatrove të mëdha. E gjeje djaloshin shqiptar te ai, vetëm te këngë që ishin ripunuar nisur prej muzikës qytetare shqiptare.

Është muaji janar i 2018-ës, kur dëgjoj në një video, vlerësimin e Placido Domingos për të. E shpall zërin më të mirë mashkullor. "Kur ka talent, talenti del në pah kudo që ndodhet. Rama është një prej fituesve të mëdhenj të Operalias. Është në kohën e duhur për të përgatitur gjithë repertorin që do. Dhe ai po e bën këtë brenda një kohe shumë të shkurtër. Ka kënduar në teatrot më të mëdhenj të botës. Unë besoj se zërat që kanë një lloj natyrshmërie, janë të veçantë. Kur zëri ka kualitet nuk ka rëndësi se nga vjen. Në Kosovë mund të mos jenë paraqitur shumë, por me kohë do të vijin këngëtarë të tjerë. Ai rajon është fantastik e me talente të jashtëzakonshme. Unë do të jem i lidhur me karrierën e Ramës. Edhe deri më tani e kam ftuar në disa koncerte, dhe po mendoj se cilën operë do të këndojë në të ardhmen. Jam shumë krenar me Ramën, ai ka zërin, temperamentin dhe pamjen, për të qenë një tenor i madh. Sigurisht që do të doja të shkoja në vendin e tij të origjinës dhe mezi po pres të shoh publikun e mrekullueshëm të Kosovës, një ditë duke kënduar me Ramën", thotë në një video fantastike Domingo.

I shkruaj Ramë Lahajt, dhe si kaheer, ai përgjigjet menjëherë. E ka ruajt thjeshtësinë e studentit të Tiranës, ende, pavarësisht se ndër vite, ka ngritur në këmbë publikun e Tel Avivit, të Sidneit, e më gjerë. I kërkoi një intervistë dhe ai pranon e çdo gjë tjetër do ta lexoni më poshtë.

Në parantezë më duhet të them se kjo intervistë është marrë me



Ramë Lahaj në rol

provash, në copëza pushimesh. Është marrë ndërsa ai pret që son-te të japë premierën e "Traviatës" në Operën Kombëtare të Parisit.

Ndërkaq, larg prej tij, në Istog, ai ka familjen, me të cilën është shumë i lidhur: "Si mund të iki lehtë nga vendi ku kam ecë zbatun, ku jam rritë pa kushte por me shumë dashni, si mund të iki kollaj nga shtrati i nanës time?", thotë ai, kur e pyes për këtë raport me shtëpinë e fëmijërisë.

Ky është rrëfimi i Ramë Lahajt.

**-Tetë vite më parë, unë kam takuar një artist të ri që kish mbaruar studimet në Tiranë e sapo hidhte hapat e parë në teatrot europianë. Sot, atë artist e gjeje në Operën Kombëtare të Parisit. Ramë, si ka qenë ky udhëtim pothuaj 8-vjeçar?**

Në fakt, në 2008-10 vjet më parë kam mbaruar Akademinë e

*Intervista për "GSH": "Nuk mund të iki nga vendi ku kam ecë zbatun, pa shumë kushte e me shumë dashni"*

Arteve, ndërsa në 2011 e kam filluar karrierën. Mund të them që tani është sezoni i 17-të për mua dhe, kur kthehem e shoh mbrapa, shumë gjëra kanë ndodhur që më bëjnë shumë krenar dhe që sakrificat ia ka vlejtur. Udhëtimi nuk ka qenë hiç i lehtë për shumë arsye por siç e thashë edhe me herët ia ka vlejtur.

**-Si e lexoni ju Alfredo Germont, përveçse një burrë i dashuruar, si është Alfredo i Ramës? A është i ndjeshëm, a është i fortë, si është ai përballë damës së tij?**

Alfredo për mua është nga rolet më specifike që unë bëj, e

kam kënduar shumë në fillim të karrierës sime, një rol që të japë shumë mundësi të tregosh gjithë kapacitetin vokal që më bën ta cilësoj si nga rolet më të veçanta deri më tani, rol që ka shumë nuanca si nga ato më delikatet në duete dramaticitetin, në lojën e kartave e po ashtu duetin ndoshta më të famshëm në botën e operës, siç është Brindisi.

**-Traviata në Paris, një histori dashurie e dhimbjeje në një qytet të stërmadh ku arti e historia shkrihen e takohen para syve. Ndjë entuziazëm në raportin tënd me Traviatën, pse?**

T'i ju them të drejtën debutimi im në Paris në 2016 ka qenë më i sikletshmi i karrierës sime deri më sot ishte një nga operat që e kisha ëndërruar gjatë, pastaj, duke e ditur që francezët si popull janë shumë fin, delikatë e të veçantë kjo e bënte akoma më stresues debutimin tim.

Por, në fakt, jam ndarë tejet i kënaqur nga mikpritja e audiencës së operës së Parisit. Unë në Paris kthehem për herë të dytë dhe sadoherë që rikthehem e shijoj më shumë këtë qytet kulture që vërtet të jep një kënaqësi të veçantë.

**-Me gjithë hapat e mëdhenj që ke hedhur, herë-herë të gjeje në Kosovë, në Istog, pranë familjes. Nuk iket lehtë nga rrënjët, apo jo?**

E si mund të iki lehtë nga vendi ku kam ecë zbatun, ku jam rritë pa kushte, por me shumë dashni, si mund

të iki kollaj nga shtrati i nanës time? Asnjëherë nuk do largohem bile kur bëhet muaji pa shkuar fillon e më kap një siklet sa as sukcesi nuk ka më lezet ndaj edhe rikthehem gjithmonë në Istog, te shtrati i nanës, sepse është frymëzim për të ecë para.

**-Babain e humbët ndërsa kishit në duar një prej projekteve më të rëndësishme të karrierës në Bolshoi. Si e mposhtët dhembjen dhe si i kontrolluat emocionet atë kohë?**

"Në fakt, aty edhe e kam vërtetuar fjalën e babës që thoshte se njeriu asht ma i fortë së guri. Pas funeralit të tij, vetëm 3 ditë mbra-pa Maestro Domingo prej kohësh më kishte ftuar të këndoja në teatrin që edhe do mbante emrin e tij, event me shumë rëndësi për të e për mua, ndaj edhe u nisa me gjysmë zemre, por atje më dhanë krahë Domingo, stafi i tij e gjithë kolegët; gjë që s'do ta harroj kurrë. E njëjtë gjë ka ndodhur edhe në Bolshoi një mbështetje që s'do ta harroj sa të jem gjallë.

**-Bolshoi, Seul, Meksikë, Budapest, Helsinki, Gjermani, Itali... Sa stacione keni prekur i vetëm, me një valixhe ëndrrash, që e hapët në skena të mëdha falë një zëri të pakrahasueshëm, e një pune të pallogaritshme?**

Stacionet nuk numërohen më, janë vërtet shumë e në kontinente të ndryshme, por nuk them se udhëtoj i vetëm. Unë jam tejet i lumtur që gjithandej, përveç se mbush sallat plot, kam edhe miq që kudo që shkoj i kam aty.

**-Një ndër çastet më të rëndësishme në karrierë ka qenë interpretimi me Placido Domingon. Tanimë, legjenda e gjallë e operës ka dhënë një vlerësim të jashtëzakonshëm për ju. Si e pritët dhe a ndjeheni krenar, i lumtur?**

Në fakt, kjo më bën shumë krenar, por edhe të përgjegjshëm për ato që po bëj e do bëj, unë besoj që tani audienca pret vërtet shumë më shumë, sepse ka marrë mesazhin e një legjende si Domingo, që flet shumë për talentin tim dhe kjo tani do që të vërtetohet, unë personalisht jam tejet i lumtur dhe besoj që po ia dal mirë.

**-Ku do të të gjejmë në vitet e ardhshme?**

E ardhmja ime është e planifikuar, deri në 2021 janë shumë debute, shumë rikthime, shumë qendra të mëdha që, në fakt, mezi po pres që t'i realizoj, nuk ka gjë më të mirë se të jesh i dëshiruar nga gjithë këto metropole botërore.







**Atentati ndaj politikanit në Mitrovicë, reagon portali serb: Është parë sulmuesi**

**"Kurir": Kamerat kanë regjistruar vrasësin e Oliver Ivanoviçit**



Hoti, zëvendëskomandant i policisë së Kosovës në Mitrovicën veriore ka thënë se grupi hetimor po i zhvillon hetimet, por nuk ka detaje të reja. "Policia aktualisht po i heton xhirimet e kamerave të vendosura nëpër gjithë qytetin. Policia punon sipas autorizimeve të prokurorit e hetimet i kryen policia e Kosovës, e cila punon në dy turne ndërsa punën e saj e mbikëqyrin dy prokurorë: një serb dhe një shqiptar. Për rastin po punojnë dhjetë policë e monitorimin e bën EULEX përmes të cilit këmbëhen informatat", ka thënë Hoti.

Gjatë shikimit të regjistrimeve në kamera është parë vrasësi i liderit të serbëve të Kosovës Oliver Ivanoviç, i vrarë më 16 janar para selisë së partisë së vet në Mitrovicën e veriut, shkruan portali serb "Kurir". Sipas portalit, me rastin e shikimit të regjistrimeve të kamerave, vërehet vrasësi i Ivanoviçit. Atij nuk i vërehet fytyra, por ky element megjithatë mund të ndihmojë, konstaton ky portal serb. Xhirimet nga rreth 20 kamera në pjesën veriore të

**PORTALI**  
"Është e çuditshme se asnjëra nga kamerat në qytet nuk ka qenë e kthyer nga Mitrovica Jugore. Megjithatë, gjatë shikimit të xhirimeve, në njërin nga to, është kapur sulmuesi i Ivanoviçit. Nuk shihet fytyra e tij, është i xhiruar nga shpina, por ky material megjithatë mund të ndihmojë".

Mitrovicës veriore, sikur dhe ato nga lokalet e partisë së Ivanoviçit, janë parë detajisht dhe, siç thotë "Kurir", në njërin nga to shihet vrasësi i Oliver Ivanoviçit. Burimi i kësaj gazete online, të cilin ajo nuk e emëron, ka thënë se kjo mund të ndihmojë shumë për zbulimin e vrasësve të Ivanoviçit. "Është e çuditshme se asnjëra nga kamerat në qytet nuk ka qenë e kthyer nga Mitrovica

jugore. Megjithatë, gjatë shikimit të xhirimeve, në njërin nga to, është kapur sulmuesi i Ivanoviçit. Nuk shihet fytyra e tij, është i xhiruar nga shpina, por ky material megjithatë mund të ndihmojë", ka thënë bashkëbiseduesi pa emër i portalit, i cili ka shtuar: "Të gjitha kamerat kanë xhiruar ekskluzivisht vetëm veriun e komunës, ndërsa organet përkatëse ende po i presin xhirimet nga pjesa jugore e Mitrovicës, e cila kontrollohet nga shqiptarët. Besim

Përdorimi i thëngjillit, Sejdiu: Të ndihmohen familjet e varfra me mënyra të tjera ngrohjeje

**Ndofja e ajrit në Kosovë, deputetët kërkojnë të merren masa**  
*Kadri Veseli: Qeveria të votojë për izolimin e shtëpive*

Kuvendi i Kosovës ka zhvilluar seancë të jashtëzakonshme lidhur me ndotjen alarmante të ajrit në Prishtinë. Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë konsideruar gjendjen aktuale të cilësisë së ajrit si mjaft shqetësuese jo vetëm në Prishtinë, por edhe në zona të tjera të Kosovës. Si të domosdoshme nga deputetët është theksuar përmirësimi i politikave mjedisore lidhur me cilësinë e ajrit. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli ka kërkuar bashkëpunimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse që të ndikojnë në përmirësimin e ajrit në Prishtinë dhe komunat e tjera. Ai ka kërkuar të krijohet një buxhet i veçantë për përkrahjen e investimeve të qytetarëve dhe bizneseve, me të cilat ulen shpenzimet e jetesës dhe rritet cilësia e shëndetit, duke investuar në izolimin e shtëpive dhe ndërtesave të paizoluara në Kosovë. "Kemi një projekt të jashtëzakonshëm, projektin amerikan të MCC-së, i cili ka ndarë tashmë 22 milionë dollarë. Ky Kuvend të votojë që qeveria e Kosovës të ndajë 30 milionë euro për këtë qëllim që do të përmirësojë ekonomitë familjare, në veçanti izolimin e shtëpive. Pastaj zgjerimi i projektit të koogjenerimit dhe mbjellja e drunjeve në zonat urbane. Trajtimi i ujërave të zeza, trajtimi e mbeturinave..." ka thënë Veseli. Gjatë kësaj jave, të dhënat që ka ofruar ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovës kanë treguar se vlerat e PM 2.5 është disa herë jashtë normales. Dardan Sejdiu, deputet nga Lëvizja Vetëvendosje ka bërë disa propozime për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Ai ka theksuar se projek-



**KADRI VESELI**  
"Kemi një projekt të jashtëzakonshëm, projektin amerikan të MCC-së, i cili ka ndarë tashmë 22 milionë dollarë. Ky Kuvend të votojë që qeveria e Kosovës të ndajë 30 milionë euro për këtë qëllim që do të përmirësojë ekonomitë familjare, në veçanti izolimin e shtëpive. Pastaj zgjerimi i projektit të koogjenerimit dhe mbjellja e druve në zonat urbane. Trajtimin e ujërave të zeza dhe trajtimin e mbeturinave".

**Projekti**

ti i koogjenerimit ka qenë një nga shembujt më të mirë se si mund të përdoret një burim i energjisë për të menjauar një ndotës, siç ishte mazuti në ngrohoren Termokos. "Sipas një studimi që është bërë, me 24 milionë euro mund të dyfishohet kapaciteti i koogjenerimit, nga 140 megavat energji termike në 280 megavat energji termike. Kjo do t'i

nuk shkaktojnë ndotje të ajrit", ka thënë Sejdiu. Në anën tjetër, deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Besa Gaxherri, ka kritikuar vendimin e Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Mjedisit për ndalimin e qarkullimit të veturave në kryeqytet, si pjesë e masave për ndalimin e ndotjes së ajrit. Gaxherri ka propozuar masa tjera për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj ka bërë të ditur se Bashkimi Evropian gjatë këtij viti do të ndajë 34 milionë euro për ndërrimin e elektrofitrave për termocentralin Kosovën B, filtra këta të cilat nuk janë ndërruar që nga viti 1985. Seanca e Kuvendit të Kosovës do të vazhdojë edhe të enjten kur pritet që deputetët të dalin me rekomandime ose rezolutë, për hapa konkret për të siguruar një zgjidhje afatgjatë rreth përmirësimit të cilësisë së ajrit. Korporata Energetike e Kosovës, përdorimi i thëngjillit për ngrohje, veturat e shumta, kushtet e pafavorshme atmosferike po konsiderohen nga institucionet e vendit faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit në Kosovë. Komuna e Prishtinës dhe Qeveria e Kosovës kanë marrë masa të caktuara, në përpjesë për ta ulur nivelin e ndotjes së ajrit. Ato kanë ndaluar shitjen e thëngjillit brenda territorit të Prishtinës, si dhe qarkullimin e të gjitha automjeteve brenda qytetit të Prishtinës nga ora 6:00 deri në orën 22:00, përveç atyre të transportit publik, automjeteve emergjente, të policisë, të misioneve diplomatike, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të EULEX-it, inspeksionit dhe taksive të licencuara.

**SHKURT**

**Spanja nuk ndryshon qëndrim ndaj Kosovës**

Spanja ka ripërsëritur edhe një herë qëndrimin e saj kundërshtues për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Sipas mediave në Beograd, Madridi zyrtar nuk ka hequr dorë nga qëndrimi i saj rreth njohjes së pavarësisë së Kosovës. Në një përgjigje për Novisat, Ministria e Jashtme e Spanjës ka thënë se Kosova mund të futet në Bashkimin Evropian vetëm si një rajon i Serbisë. "Qëndrimi i Spanjës vazhdon të jetë se ne nuk e njohim shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës, është e bazuar në parimin e mbrojtjes së integritetit territorial të shteteve, respektivisht të drejtës ndërkombëtare dhe sundimin e ligjit", thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Jashtme të Spanjës, publikuar në media serbe. Më tej sipas mediave serbe, çështja e Katolonisë ka forcuar edhe më tej qëndrimin refuzues të Spanjës për ta njohur pavarësinë e Kosovës.

**Shpërthim i fuqishëm në Ankara**

Një shpërthim i fuqishëm ka tronditur kryeqytetin turk Ankara mbrëmjen e së enjtes. Sipas agjencisë ndërkombëtare të lajmeve, "Reuters", shpërthimi ka ndodhur rreth orës 20:05 (me orën lokale) dhe është dëgjuar në shumë pjesë të qytetit me pothuajse 6 milionë banorë. Shpërthimi mësohet se ka ndodhur në Zyrën Qendrore të Tatimeve dhe shkak është bërë kompresimi i gazit natyror. Deri më tani nuk janë raportuar viktima, por vetëm dëme të mëdha materiale. Në një njoftim për mediat, zyra e guvernatorit të Ankarasë tha se ndërtesa fatmirësisht ka qenë bosh në momentin e shpërthimit. Në vendngjarje kanë mbërritur forcat e policisë, të cilat po hetojnë për shkakun e shpërthimit të fuqishëm që ka shkaktuar panik të madh tek banorët. Ankara është tronditur nga një seri sulmesh me bomba në vitet 2015-2016, të cilët kanë shkakuar qindra të vdekur.

**Zjarr në azil, vdesin 11 persona**

Një zjarr në një shtëpi të moshuarish i ka marrë jetën të paktën 11 personave. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në Sapporo në ishullin japonez të Hokkaidos, Japoni. Mësohet se nga flakët shpëtuan vetëm 5 persona, ndërsa të tjerët nuk mundën dot. Ndërtesa ishte e vendosur në një zonë banimi rreth 1.5 kilometra në veri të stacionit hekurudhor të Sapporos. Viktimat janë tetë burra dhe tri gra të moshuar, identitetet e të cilëve nuk janë bërë të ditura ende. Policia po përpiqet të identifikojë 11 viktimat, të cilët jetonin prej disa vitesh në shtëpinë e të moshuarve.



Votoi kundër në OKB, Trump: Do të ketë fonde vetëm për vendet mike

# Njohja e Jeruzalemit, Shqipëria "armike" e SHBA-ve

## Vendimi për Izraelin, vendi ynë "humbet" investimet

Më 21 Dhjetor në OKB, Shqipëria dhe 127 shtetet që votuan kundër vendimit të Trump për njohjen e Jeruzalemit si kryeqytet i Izraelit, rrezikojnë të mos përfitojnë më fonde amerikane. Në fjalimin e parë mbi gjendjen e vendit Presidenti Trump i propozoi Kongresit që të miratojë një ligj që tani e tutje miliona dollarë amerikanë që jepen në formë ndihme financiare t'u shkojnë vetëm miqve të Amerikës. "Muajin e kaluar ndërmora një hap të miratuar njëzëri nga Senati vetëm pak muaj më parë: Njohja Jeruzalemit si kryeqytet i Izraelit. Pak më vonë, dhjetëra vende votuan në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kundër të drejtës sovraane të Amerikës për ta bërë këtë njohje. Taksapaguesit amerikanë u dërgojnë me bujari këtyre vendeve miliarda dollarë ndihma çdo vit. Kjo është arsyeja përse sonte po i kërkoj Kongresit të miratojë një ligj që dollarët amerikanë për ndihmat e huaja t'u shërbejnë gjithmonë interesave amerikane dhe t'u shkojnë vetëm miqve të Amerikës. Ndërsa forcojmë miqësitë në mbarë botën, ne gjithashtu po rikthejmë qartësinë se cilët janë kundërshtarët tanë".

nëse kjo nismë e Trump për të ndëshkuar shtetet që ai tashmë i konsideron armike do të marrë votat e kongresmenëve. Në fjalimin para Kongresit në 1 orë e 20 minuta, Trump garantoj për marrjen e shtetësisë nga 1.8 milionë emigrantë të paligjshëm të sjellë në SHBA nga prindërit e tyre në një moshë të re. Trump konfirmoi dhënie fund të lotarisë së vizave, si dhe ndërtimin e murit në kufirin me Meksikën. Presidenti Trump tha se me ardhjen e tij në pushtet u krijuan 2.4 milion vende të reja pune, u shkurtuan taksat dhe janë planifikuar trilionat dollarë për riparimin e rrugëve, urave, si dhe modernizimin e aeroporteve. Presidenti paralajmëroi rritjen e fondëve për armët bërthamore dhe për mposhtjen e ISIS. Ndërkohë që në 21 dhjetor rezoluta jodetyruese u miratua nga 128 shtete ku 9 votuan kundër dhe 35 vende abstenuan. Mes vendeve që votuan kundër SHBA-së dhe pro rezolutës së OKB ishte dhe Shqipëria. Shqipëria kishte deklaruar gjithnjë ale-



### FJALIMI I TRUMP

"Muajin e kaluar ndërmora një hap të miratuar njëzëri nga Senati vetëm pak muaj më parë: Njohja Jeruzalemit si kryeqytet i Izraelit. Pak më vonë, dhjetëra vende votuan në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kundër të drejtës sovraane të Amerikës për ta bërë këtë njohje. Taksapaguesit amerikanë u dërgojnë me bujari këtyre vendeve miliarda dollarë ndihma çdo vit. Kjo është arsyeja përse sonte po i kërkoj Kongresit të miratojë një ligj që dollarët amerikanë për ndihmat e huaja t'u shërbejnë gjithmonë interesave amerikane dhe t'u shkojnë vetëm miqve të Amerikës. Ndërsa forcojmë miqësitë në mbarë botën, ne gjithashtu po rikthejmë qartësinë se cilët janë kundërshtarët tanë".

ancë strategjike me SHBA, por si përfundim ndau qëndrim të ndryshëm me administratën amerikane në

OKB. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka miratuar një rezolutë që i bën thirrje Shteteve të Bashkuara të

Amerikës të tërhiqet nga vendimi i saj për njohjen e Jeruzalemit si kryeqytet të Izraelit. Ambasadorja e

### NJOHJA E JERUZALEMIT

Më 21 dhjetor rezoluta jodetyruese u miratua nga 128 shtete ku 9 votuan kundër dhe 35 vende abstenuan. Mes vendeve që votuan kundër SHBA-së dhe pro rezolutës së OKB ishte dhe Shqipëria. Shqipëria kishte deklaruar gjithnjë aleancë strategjike me SHBA, por si përfundim ndau qëndrim të ndryshëm me administratën amerikane në OKB.

SHBA-së në OKB, Nikki Haley tha se çfarëdo vendimi që marrin Kombet e Bashkuara nuk do të ndikojnë në bindjen e Uashingtonit për njohjen e Jeruzalemit si kryeqytet të Izraelit. Në fjalimin që mbajti në seancën e 21 dhjetorit, ambasadorja Haley tha se Shtetet e Bashkuara janë kontribuesja më e madhe e Kombeve të Bashkuara, shumë më e madhe se vendet e tjera dhe se kjo duhet të respektohet nga të tjerët. Ndërkohë, Presidenti i Palestinës, Mahmoud Abbas e cilësoi "fitore për Palestinën" votën në OKB.

### SHBA, DEPUTETËT REPUBLIKANË PËRFSHIHEN NË AKSIDENT HEKURUDHOR



Një tren që mbante deputetë republikanë ka goditur një kamion në shinat e Virxhinias, duke vrarë shoferin e kamionit, raporton BBC. Gjashtë persona u plagosën, duke përfshirë edhe një tjetër pasagjer kamioni, i cili u transportua me helikopter në gjendje kritike për jetën. Asnjë anëtar i Kongresit nuk ka pësuar lëndime të rënda, thanë zyrtarët.

**BLUE TOOTH**

THASHETHEME

MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta vipave

çdo të shihet falas me GAZETA SHQIPTARE

Opinion i Ditës

# A është mirë me qenë shqiptar?

Nga Desada Metaj


(vijon nga faqja 1)

... mes politikës dhe një pjese të ndjeshme të opinionit publik. Ishin takimet mes dy ministrave të Jashtëm, posaçërisht ai i fundit në Korçë, që ndezën fitilin e zjarrit thuajse të pashuar të debatit patriotik shqiptar.

Ndërsa, pala shqiptare u tregua e rezervuar në publikimin e detajeve të takimit, ishte ministri Kotzias ai që informoi publikun grek, po ashtu i ndjeshëm për problematikën e marrëdhënies me shtetin fqinj. Dhe sigurisht që pjesa me delikate, ajo e marrëveshjes detare nga ku buruan dhe akuzat për shitjen apo faljen e territorit shqiptar në këmbim të një mbështetje të Greqisë për hapjen e negociatave, zuri dhe vendin më kryesor në debatin publik të dy ditëve të fundit.

Ajo që dihet me siguri është që Shqipëria do të negociojë një marrëveshje të re për përcaktimin e kufijve detarë me Greqinë. Kjo duket krejt normale pas rrëzimit që Gjykata Kushtetuese i bëri marrëveshjes që qeveria Berisha nënshkroi me palën greke. Një vendim gjykatë që, në fakt, shërbeu për shumë kohë dhe si kalë beteje për Edi Ramën, asokohe në opozitë. Me një shikim të shpejtë, pika e parë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese që e shpalli të pavlefshme marrëveshjen e qeverisë Berisha thotë: "Mospajjsja e delegacionit shqiptar me plotfuqi të rregullt nga Presidenti i Republikës për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e marrëveshjes".

Por tani që vendet janë këmbur



er nuk dihet se si dhe sa ka informuar ministri i Ramës presidentin e vendit. Ky i fundit në një të vetmin reagim, me gjuhë diplomatike dhe të kujdesshme ka deklaruar se po ndjek zhvillimet dhe debatin. Por zyrtarisht, burime të

opinion.al bëjnë me dije se ministri i Jashtëm i Shqipërisë nuk ka raportuar ende zyrtarisht tek kreu i shtetit. Krejt ndryshe nga homologu i tij, që me të mbërritur në Athinë u takua dhe informoi presidentin dhe kryetarin e par-

lamentit për takimin dy ditor me homologun shqiptar. Ditmir Bushati u detyrua të bënte një deklaratë për shtyp vetëm pasi Kotzias me daljet e tij publike zbardhi detaje të marrëveshjes.

Në fakt, marrëveshja detare,

ligji i luftës, pronat e popullsisë çame, varrezat e ushtarëve grekë apo dhe ndryshimet e teksteve shkollore janë episode patriotike që nuk ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e rrënuar të jetës së shqiptarëve. Të mësuar me skandale ministrash që bashkëjetojnë me krimin, trafikantët dhe korrupsionin, një marrëveshje sado cenuese për disa km vijë bregdetare mund të shërbejë thjesht si thërrime për të peshkuar patriotizmin dhe për të ndezur debatin polifonik patriotik. Një sport të preferuar për shqiptarët, që në pjesën më të madhe janë gati të harrojnë kriminalizimin, vjedhjen nga koncesionet, rritjen e taksave, shëndetësinë e rrënuar, vetëm e vetëm për t'u përfshirë në një debat me patriotë dhe tradhtarë. Që në fakt është thjesht telenovela e radhës, e servitur me kujdes ndërkohë që pjesa më e rëndësishme, marrëveshja e re me Greqinë mbetet e paqartë për të gjithë shqiptarët.

Një marrëveshje që mbi të gjitha ka nevojë për transparencë, ekspertë të zotë dhe jo vasalë partish dhe pse jo, bashkëpunimin me të gjithë institucionet përgjegjëse dhe ato kushtetuese. Së paku, për t'u treguar shqiptarëve se për ata që na drejtojnë, patriotizmi nuk është vetëm kisha greke e Dhërmiut që përdoret nga Edi Rama për të marrë vota, as premtimet për pronat e camëve për të afruar PDIU-në në qeveri. Dhe aq më pak të jetë streha e fundit e një kabineti skandalesh që më shumë se disa km det, ka mbjellë dhe shitur kaq shumë kanabis sa do të mjaftonte të blinte dhe një ishull të pabanuar grek.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



Opinion *i* Ditës

# 4 sfidat gjeopolitike të "Botërorit 2018"

Nga Sali Metani

(vijon nga faqja 1)

... ndërkombëtare të vitit 2018. Njihën tashmë 32 ekipet përfaqësuese të vendeve pjesëmarrëse të kampionatit të ardhshëm botëror. Si të gjitha garat sportive ndërkombëtare shumë të mediatisuara, kampionati "Botëror 2018" pritet të ketë një impakt të madh kulturor, diplomatik dhe ekonomik.

Pascal Boniface, drejtor i Institutit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare Strategjike në Francë, në botimet e tij të kohëve të fundit të titulluara "Gjeopolitika e sportit dhe lojërat e tij olimpike" thekson se kampionatet botërore të futbollit janë një moment i fuqishëm në skakierën politike të marrëdhënieve ndërkombëtare.

E veçanta e këtij Botërori pritet të ketë një sinjifikim të veçantë për arsye të vendit ku do të zhvillohet, Rusia, dhe datës së tij nga 14 qershori deri më 15 korrik 2018. Me gjithë "pasigurinë e lavdishme" të sportit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, vëzhguesi i vëmendshëm dhe *fansi* të rreptë mundet tashmë të identifikojnë disa sfida.

## RUSI, TË SHMANGEN DISFATAT E LOJËRAVE OLIMPIKE TË SOÇIT 2014

Për Rusinë, vendin organizator, prioritet do të jetë të evitohen rezultatet e dobëta të Lojërave Olimpikë të vitit 2014. Të hartuara nga presidenti rus si një manifestim prestigjioz, ato u mbyllën me një bilanc imazhi gjysmëgjyresh: në klasifikimin e medaljeve Rusia u rendit në vendin e parë me 13 medalje ari, por në planin politik ajo mori goditje në planin ndërkombëtar: aneksimi i Krimesë, lufta në Donbas, ligji për homoseksualët, dopingun i organizuar, etj.

Sanksionet ekonomike nga ana e vendeve europiane dhe amerikaneve, anulimi i takimit të vendeve të G8 i parashikuar të mbahet në muajin mars në Soçi dhe mbi të gjitha, miratimi i sanksioneve nga europianët krijuan një sërë disfatash, duke zbehur yllin e Rusisë nën syrin e mediave ndërkombëtare. Evitimi dhe përsëritja e tyre do të jenë objektivi i parë i "Botërorit 2018" për Rusinë.

## BE: TË RUHET FRYMA E EKIPI

Europianëve do t'i duhet të zgjedhin stilin e tyre të lojës diplomatike për "Botërorin 2018". Ekipet kryesore rivale dhe partneret e Rusisë si Gjermania, Franca, Spanja dhe sidomos Polonia janë kualifikuar.

A do të zgjedhin ato një lojë të ashpër si në vitin 2014, kur presidenti Holand dhe kancelarja Merkel dhe komisioneria europiane Reding refuzuan ftesën për në Lojërat Olimpikë të Soçit? Apo do të përpigën për pajtimin duke asistuar në ndeshjet? Në këtë kontekst do të luhet solidariteti i BE-së me Ukrainën dhe shtetet baltike të cilët nuk u kualifikuan në kampi-



onatin botëror) dhe diskutimet e brendshme në Bashkimin Europian mbi sanksionet kundër Rusisë. Për europianët, të shkojnë të veqar në "Botërorin 2018" do të ishte një shenjë dobësimi e frymës së ekipit të BE-së.

Zotërimi i financave i klubit 'Rusi'

Në planin financiar, thelbësore do të jetë zotërimi i kostove të organizimit, sepse situata ekonomike e Rusisë mbetet shqetësuese. Qysh prej vitit 2014, GDP e saj është tkurrur në 3% dhe niveli i varfërisë është rritur. Financat publike janë vënë në provë nga sanksionet perëndimore dhe kurisi i hidrokarbureve: në vitin 2010, kur u vendos që kampionati botëror të zhvillohej në Rusi, çmimi i një fuçje naftë ishte rreth 70 dollarë, kundrejt çmimit 50 dollarë sot.

Për të pasur sukses në këtë operacion marketingu ndërkombëtar, Rusia ka vendosur që ndeshjet të luhen në stadiumet në Rusinë europiane, me qëllim që të lehtësojë zhvendosjen e turistëve

perëndimorë. Por ekipi i Rusisë gjithmonë has vështirësi në tërheqjen e investitorëve ndërkombëtarë, për të cilët ka shumë nevojë, siç e dëshmon kërkimi për financime saudite.

Lojërat Olimpikë të Soçit ishin një paralajmërim: me një buxhet rekord prej 36 miliardë euro, skandale të shpërdorimit të fondeve gjeneruan pak të ardhura ekonomike. Sfida është të tregohet që prestigji kombëtar dhe "soft-power" mund të akomodohen me një menaxhim rigoroz të projekteve. Rusia ka dhënë shenja duke zvogëluar numrin e stadiumeve, ku do të zhvillohen ndeshjet nga 16 në 11 për të zvogëluar kostot. Por investitorët nuk kanë besim në vendet (dhe klubet) ku "soft-power" shpesh rrimon me shpenzime të mëdha.

## PUTINI I IV, DREJT NJË SHUGURIMI TË DREJTUESIT TË LOJËS?

Botërori i 2018-ës do të zhvillohet disa muaj pas zgjedhjeve presidenciale në Rusi, që do të mbahen më 18 mars dhe 8 prill

2018, në momentin kur pa dyshim Vladimir Putin do të nisë mandatin e tij të katërt. Rezultatet elektorale kanë gjasë të jenë të sigurtat.

Por suksesin e "Botërorit 2018" do të jetë vendimtar për statusin e Putinit të IV, ashtu si pjesëmarrja në zgjedhjet: atentate, një bojkot diplomatik perëndimor, skandale financiare, stadiume të boshatisur apo një performancë e dobët e përfaqësueses ruse do të pengonin vullmin e ri të kërkuar nga administrata presidenciale pas dy dekadave në pushtet.

Përkundrazi, një sukses imazhi gjatë zhvillimit të kampionatit botëror nën syrin e mediave ndërkombëtare, në një Moskë tërësisht të modernizuar, do të forconte akoma influencën ndërkombëtare të presidentit rus.

Një fitore e ekipit kombëtar rus në mbërme më 15 korrik do ta ndizte stadiumin e ri në Luzhnik, me siguri do t'i jepte atij dhe drejtuesit të Federatës ruse një peshë plotësuese në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

## HOROSKOPI

### DASHI

Ditën e sotme do t'ju mungojë shpejtësia për të tejkaluar kundërshtarin tuaj si edhe për të fituar kështu një avantazh të konsiderueshëm ndaj tij! Do të jetë një përballje e fuqishme, por ajo që është e sigurt është se nuk do ta shisni kursesi lirë lëkurën tuaj.

### DEMI

Edhe pse duhet të qortoni dikë që nuk është shumë i vëmendshëm, tregohuni i qetë. Vëreni veten gjithmonë në pozicionin e tjetrit, përpara se ta kritikoni. Në çastin më të posaçëm do të dini gjithmonë t'i rimerrni në dorë frerët e situatës.

### BINJAKET

Më shumë se për punën dhe afatet që mbarojnë, po mendoni sesi të argëtoheni me ndonjë rreng të bukur që t'i kurdisni mikut tuaj më të mirë! Në fillim puna, pastaj kënaqësia, ndryshe do të hani një të ulëritur jo shumë të këndshme.

### GAFORJA

Do të prisni me frikë ardhjen e një mesazhi të rëndësishëm, që po ju mban nën tension. Hiqeni këtë mendim, nëse nuk doni që të zmadhoni ankthin. Ndoshta adresa ishte gabim ose dërguesi e ka harruar fare. Por ju nuk i duroni dot pakujdesitë.

### LUANI

Shumë kërkesa që nuk presin rrezikojnë t'ju vënë për poshtë. Keni dëshirë t'ua përmbushni dëshirat të tjerëve, por nuk mund të jeni i pranishëm me të gjithë! Gjenero ekulibrin duhur, duke u udhëhequr nga instinkti dhe nga bionsensit i thehshës.

### VIRGJERESHA

Para se të futni dorën në kuletë, bëni disa llogari, për të kuptuar se cili shpenzim i tepërt, që nuk ishte i llogaritur mund ta merrni në konsideratë. Nëse mendoni se mund t'ia dini pa pasur një gjë të caktuar për të pasur diçka tjerë, vetëm ju e keni në dorë të zgjidhni.

### PESHORJA

Nëse është e vërtetë se mjafton të duash për ta bërë diçka, është, gjithashtu, e drejtë të thuash se të vazhdoni në drejtimin e gabuar, ju bën të humbni shumë nga koha tuaj e vyer. Mund të keni nevojë për një ndihmesë. Por nuk duhet ta pranoni nëse nuk është në avantazhin e juaj.

### AKREPI

Pasiguri të vogla për të shprehur emocionet tuaja të brendshme mund ta bëjnë të vështirë që partneri i jetës t'ju kuptojë. Dukeni i përhumbar, edhe pse në të vërtetë jeni duke pleqëruar thellësisht mbi një çështje që ju shqetëson.

### SHIGJETARI

Këtë ditë mendimet tuaja do të jenë më pak të turbullta dhe mund të ndriçoni të gjitha zonat e errëta që ju trembin. Në fund të fundit, kjo është edhe për të mirën tuaj. Nëse partneri ju kërkon pak kohë, jini në dispozicion menjëherë dhe mos bëni fjalë.

### BRICJAPI

Jeni shumë i aftë për të çuar përpara negociatat raskapitëse. Por në fund edhe ju mund të ndiheni të shtypur nën ngarkesën e tepërt të përgjegjësisë. Duhet të mësoni të ndani dhe të delegoni punët: ju nuk mund të mbani gjithmonë gjithçka mbi supë.

### UJORI

Bashkëpërimi i planetëve do t'ju favorizojë lëvizjet, qofshin këto si për kënaqësi ashtu edhe për punë. Negociatat dhe puna do të ecin vaj. Priteni pozitivisht risinë. Edhe pse gjërat nuk ju duken shumë interesante, shumë shpejt ato do të jenë!

### PESHQIT

Të dish të zgjedhësh për më të mirën nuk është e lehtë, kur bëhet fjalë të mendoni si për mirëqenien tuaj ashtu edhe për atë të të tjerëve. Njerëzit i besojnë instinktit tuaj dhe kjo ju pëllëng. Por lind pyetja nëse ju i zini besë apo jo?

STOLI AXURR



Alessandro Kostakurta, një nga emrat legjendarë të Milanit në vitet '80-'90 është emëruar dje zëvendës-president i përkohshëm i Federatës Italiane të Futbollit (FIGC). Mungesa e një akordi për zgjedhjen e presidentit të ri në zgjedhje ka sjellë ndërhyrjen e Komitetit Olimpik Italian, që ka marrë situatën në dorë dhe sipas ligjit, ka vendosur si president të përkohshëm të FIGC Sekretarin e

Trajneri i Italisë, në dorë të Billi Kostakurtës

Përgjithshëm të saj, Roberto Fabricini. Fabricini zgjodhi Kostakurtën si këshilltarin sportiv, në detyrën e zëvendës-presidentit dhe ish-mbrojtësi do të jetë ai që do të takojë kandidatët potencialë për të marrë drejtimin e përfaqë-

sueses italiane, për vendin e lënë bosh që nga largimi i Venturës në nëntor. "Emrat janë ata që keni dëgjuar, persona që kanë ndarë me mua ndeshje në Kombëtare. Si Mançini për shembull, sa për të përmendur një nga të mundshmit. Duhet të fil-

lojmë bisedimet. Nuk duhet ngutur, por duhet të fillojmë të lëvizim dhe të flasim me ta sa më parë të jetë e mundur. Është i nevojshëm një seleksionues. Konte m'i ka shtuar dyshimet që kisha në Europianin e kaluar, ka bërë një mrekullim sportive. Duhet vlerësuar personat. Ne italianët jemi më të mirë në botë si kuzhinierë, trajnerë dhe kërkues", tha Kostakurta.

Zv.presidenti i UEFA-s, Grigoriy Surkis takon kryeministrin Rama dhe Armand Dukën



Garantimi i zgjedhjeve demokratike dhe mbi të gjitha pa ndërhyrje të palëve të treta në Federatën e Futbollit sollin në Shqipëri një prej eksponentëve më të lartë të UEFA-s. Rreth mbarëvajtjes së procesit të 7 shkurtit, zv.presidenti i Konfederatës Europiane, Grigoriy Surkis u takua me kryeministrin Edi Rama, ndërsa më pas zhvilloi një bisedë me presidentin e FSHF-së, Armand Duka. "Delegacioni ynë erdhi në Shqipëri me një mision paqeje, sipas udhëzimeve që kemi marrë nga presidenti i UEFA-s, zoti Ceferin. U takuam me kryeministrin, ishte një ndeshje që zgjati 90 minuta, por nuk kaloi shtesë apo penallti". E dëgjua njëri-tjetrin dhe kuptuam pozicionet e secilës palë. Qëllimi i vizitës sonë lidhej me shqetësimin, pa sinjalizimeve që kemi marrë së fundmi rreth tentativave të palëve të treta për të ndërhyrë në procesin zgjedhor. Synimi ynë është një dhe i vetëm: të nënvijëzohjmë se

# UEFA takon Ramën: Nuk duam ndërhyrje të palëve të treta

Zgjedhjet në FSHF, mision i posaçëm nga Nioni



duhen respektuar principet e UEFA-s, principi i demokracisë, i transparencës dhe i zgjedhjeve të lira. Principe, të cilat nuk lejojnë ndërhyrjen e palëve të treta në procesin zgjedhor

të Federatës Shqiptare të Futbollit". Zgjedhjet për mandatin e presidentit të federatës, por edhe për Komitetin Ekzekutiv do të monitorohen përpara, gjatë dhe pas procesit

dhe mesazhi i UEFA-s është i qartë. "Ndamë opinionin, shpresoj dhe besoj se na dëgjuan me kujdes. Delegatët e FIFA dhe UEFA do të jenë të pranishëm në Asambleenë Zgjedhore të 7 shkurtit dhe

do të vazhdojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim. Nëse zgjedhjet do të zhvillohen demokratike dhe transparente, ne do të përgëzojmë fituesin. Se cili do të fitojë, do ta shohim në përfundim të asamblesë". Zv.presidenti i UEFA-s, Surkis nuk preferoi të komentonte nëse ka fakte për ndërhyrjen e palëve të treta në zgjedhjet e FSHF-së, por bëri thirrje se për të ecur përpara, bashkëpunimi i autoriteteve vendore me federatën është i nevojshëm. "Ne nuk jemi hetues dhe as prokurorë. Ne jemi institucioni i përgjegjës për zhvillimin e futbollit në Europë. "Ne kujdesemi për futbollin", kjo është moto jonë. E kuptojmë që zhvillimi i futbollit nuk është i mundur në asnjë vend pa punën dhe energjitë e au-

toriteteve shtetërore përkrah federatave. Futboli është një projekt madhor social, që ndikon në jetën dhe mënyrën cilët jemi, qoftë në Shqipëri dhe Gjermani apo në Ukrainë e Zvicër. Kudo futbollit është shumë i rëndësishëm dhe mendoj se UEFA është një shembull i mirë për t'u ndjekur, duke u kujdesur për futbollin dhe duke shpërndarë të ardhurat për zhvillimin e këtij sporti, kudo. Këto janë qëllimet dhe puna jonë, njerëzit që na ndjekin duhet të bëjnë të njëjtën gjë". Numri 2 i UEFA-s u shfaq i rezervuar edhe rreth takimit me kryeministrin Rama dhe faktit nëse mori garanci se procesi në Asambleenë Zgjedhore të 7 Shkurtit do të jetë i pavarur: "Nuk firmosëm asnjë memorandum, por dëgjua njëri-tjetrin dhe besoj se secila palë ka nxjerrë përfundimet e veta. Jemi në një proces që vazhdon dhe këto janë komentet e vetme që mund t'ju jap për momentin. Gjithçka do të bëhet hap pas hapi".

FIRMOS SULMUESI

## Një gjigant për sulmin e Kukësit, prezantohet Balde

Klubi i Kukësit ka bërë dje prezantimin e sulmuesit nga Guinea Bisau, Amido Balde, me të cilin marrëveshja ishte arritur pak ditë më parë. Prezantimi është bërë nga drejtori sportiv i klubit kampion, Nderim Nexhipi, dhe menaxheri Naim Halli. Një afrim me vlera për skuadrën veriore, që i shton organikës së saj një lojtar shtatë-lartë për repartin e avancuar. 26-vjeçari Balde është 1.93 m i gjatë dhe ka një karrierë të pasur, edhe pse është në një moshë të re. Trajneri Peter Pakult tani ka më shumë alternativa për sulmin, ku Balde me siguri do të jetë titullar. Ai ka luajtur me disa skuadra në Portugal, Francë dhe Belgjikë, por është bërë i njohur më shumë për një të kaluar te Sëlltiku në Skoci.



FUSHAT E STADIUMEVE MUND TË DËMTOHEN

## Botërori në rrezik nga... karkaleci!

Kampionati botëror i Rusisë mund të përfshihet në skandal dhe fajin do ta ketë... karkaleci. Alarmin e ka ngritur përgjegjësi i bujqësisë dhe agrikulturës në qeverinë ruse, Piotr Çekmariov, i cili thotë se në muajin kur do të zhvillohet Botërori bëhet shumimi i këtij insekti dhe vë në rrezik serioz fushat e futbollit. "Karkaleci është një rrezik i madh për Rusinë dhe kam frikë se mos bëhet ndonjë skandal shtetëror: Karkaleci pëlqen shumë zonat e gjelbra dhe fushat e futbollit mund të jenë vendi ideal. Duhet të marrim masat për këtë gjë", ka thënë Çekmariov. Kampionati botëror do të luhet nga datat 14 qershor deri në 15 korrik dhe do të zhvillohet në 12 stadione të ndryshme në 11 qytete të Rusisë. Nuk është hera e parë që do të ndodhte diçka e tillë me fushat, sepse edhe në Brazil pati probleme të shumta.



ISHULLI NË DELIR


## 'Çmendet' Premierliga, 2 miliardë euro shpenzime vetëm në janar

Epabesueshme, shifra e shpenzuar në Premier League për merkaton e futbollistëve. Shuma totale e investimeve në Premier midis verës dhe dimrit kalon shifrën e 2 miliardë eurove. Anglia vazhdon t'i lërë në hije kampionatet e tjera. Një merkato e pasur edhe në dimër, kur shifrat janë të paimagjinueshme për Serinë A në Itali apo kampionatet e tjera. Mjafton të mendosh që kalimi i Van Dijk të Liverpoolit kushtoi 85 milionë euro. Këtë janar edhe Venger ka kaluar dimrin më të pasur se kurrë, duke shpenzuar 63 milionë për Obamejang. Pa harruar Murinjon, i cili mori Sañezin për 40 milionë 6 muaj para skadimit të kontratës. Guardiola është mjaftuar me mbrojtësin Laporte, që i kushtoi 65 milionë.





**Fjalëkryqi (1)**



HORIZONTAL

1. Ishte dekret i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiqajti Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.

38. Satelit i Jupiterit.
39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstremer në sirtar.
45. Kështu shtë lojtar i under 21.
47. Eshhtë gjuajtja personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuratur më të ulëta.
5. Inicialet e Lendl.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisorë.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishte gjuha e romakëve.

15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihet kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorëzë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsja e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.


**Fjalëkryqi (2)**

HORIZONTAL


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë skllavëri.
16. Eshhtë shtypji po përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

VERTIKAL


33. Eshhtë trofet që fitohet.
  34. Ndahen nga ortakët.
  36. Një biçikletë dyshe.
  39. Qetësonte detin.
  42. Kanë dhoma që zihen.
  44. Eshhtë ekulibri në palestër.
  46. Në krye të jurisë.
  47. Numri i kuartetit.
  48. Gjysmë armate.
9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
  10. Fleming që krijoi James Bond.
  13. Janë binarë.
  15. Janë dhoma.
  16. Eshhtë i zi... pikant.
  17. Institucione Lokale Tiranë.
  19. Pagëzoi Shën Palin.
  20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
  22. Janë pamje nga puna.
  26. Janë aksione për... gol.
  27. Një fjalë për më vonë.
  29. Maria Rilke, shkrimtar.
  30. Fillojnë turnin.
  32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
  34. Eshhtë copë... torte.
  35. Mbyllin një tender.
  34. Ndo në kufij.
  38. Një pëllhurë.
  40. Lidh dy brigjet.
  41. Një pije piratësh.
  43. Fillojnë lehtë.
  45. Të fundit në sirtar.




**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

**SUDOKU**

	7		3			9			4
				2	8			6	1
8	9		1						7
		5	9	2		6			8
	1	6					3	9	
		8		6	1	2			
	2				4			8	9
4	6			1	5	7			
1			7		2			5	

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

4	9	5	2	3	7	6	8	1
7	1	2	6	8	4	3	9	5
3	8	6	9	5	1	4	7	2
2	4	8	5	1	6	9	3	7
6	3	7	8	9	2	1	5	4
1	5	9	4	7	3	2	6	8
5	2	4	3	6	8	7	1	9
9	7	3	1	2	5	8	4	6
8	6	1	7	4	9	5	2	3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Njeri lakmitar, që dëshiron që e gjithë bota të jetë e jotja. Kur gjaku yt do të bëhet ujë dhe do të rikthehet tek lumenjtë, kur kockat e tua do të bëhen dhë, dhe do t'i rikthehen tokës, atëherë do të jetë shumë vonë për të kuptuar se nuk është toka që të përket ty, por je ti që i përket tokës.


Shprehje Indiane

- Gjërat më të thjeshta janë njëkohësisht edhe më të jashtëzakonshmet, vetëm të mençurit mund t'i shohin ato.



**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm



*Thënie të mençura*

- - Suksesi ka përbërë dështimin e shumë njerëzve.
- - Suksesi nuk është rezultat i një dëgjie spontane. Ju duhet të digjini veten në zjarr.
- - Lëviz nëpër botë duke festuar, kërcyer, kënduar, si një bletë; shko nga lujja në lule, vetëm duke provuar të gjitha eksperiencat, piqesh.
- - Për të parë atë që pak njerëz kanë parë duhet të shkoni aty ku pak kanë qënë.

(Sindi Adams)  
(Regi Lic)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!

